

Gjykata e Qarkut në Prishtinë
P nr. 371/10
23 Nëntor 2011

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me trupin gjykues të përbërë prej Gjykatësit të EULEX Dr. Horst Proetel si Kryetar i Trupit Gjykues, Gjykatësit të EULEX Tore Thomassen dhe Gjykatësit Kosovar Rafet Haxha si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga Procesmbajtësi Robert Abercrombie në çështjen penale kundër

Fahredin Gashi, i njohur si Faruk, emri i babait i lindur më në fshatin vendbanimi i fundit i njohur shtetas i Kosovës, i arrestuar më 13 Korrik 2010, në paraburgim nga 14 Korriku deri më 19 Gusht 2010, në paraburgim që nga 19 Gushti 2010,

I akuzuar sipas Aktakuzës PPS nr. 460/09 dhe 09/10 të datës 5 Nëntor 2010 për veprën penale Krime lufte kundër popullatës civile, sipas Neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ), ende i ndëshkueshëm sipas Neneve 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës, në shkelje të Nenit 3 të përbashkët të katër Konventave të Gjenevës të 12 Gushtit 1949, dhe të Nenit 4 të Protokollit II të 8 Qershorit 1977, Shtesë e Konventave të Gjenevës të 1949; dhe

Hysri Rama, i njohur si Hvs. emri i babait i lindur më në fshatin shtetas i Kosovës, në liri,

I akuzuar sipas Aktakuzës PPS nr. 460/09 dhe nr. 09/10 të datës 5 Nëntor 2010 me veprën penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale, sipas Nenit 305, paragrafi 2 i KPK,

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor më:

- 15, 17, 22, 29, 30 Mars 2011;
- 12, 13 dhe 14 Prill 2011;
- 17, 24 dhe 31 Maj 2011;
- 7, 22, 23 dhe 24 Qershor 2011;
- 5 dhe 6 Korrik 2011;
- 22 dhe 23 Gusht 2011;
- 6, 7, 8, 28, 29 dhe 30 Shtator 2011;
- 17, 21 dhe 26 Tetor 2011; dhe
- 21, 22 dhe 23 Nëntor 2011;

Në praninë e të Pandehurit Fahredin Gashi dhe Avokatëve të tij Mbrojtës Kolë Krasniqi dhe Tahir Rrecaj, të Pandehurit Hysri Rama, Prokurorit Maurizio Salustro nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) dhe Palëve të Dëmtuara Mirishahe Gashi, Hyrije Gashi, Afrim Gashi dhe Myrvete Hisenaj,¹

¹ Katër palët e dëmtuara nuk kanë të pranishëm në të gjitha seancat e shqyrtimit gjyqësor. Së paku një palë e dëmtuar ka qenë e pranishme në seancat e shqyrtimit gjyqësor.

Pas shqyrtimit dhe votimit m 23 Nëntor 2011, në pajtim me Nenin 392 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), shpall publikisht dhe në praninë e palëve këtë,

AKTGJYKIM

I Akuzuari Fahredin Gashi, me shënimet personale si më lart,

SHPALLET FAJTOR

Për veprën penale sipas Neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ), ende i ndëshkueshëm sipas Neneve 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës, në shkelje të Nenit 3 të përbashkët të katër Konventave të Gjenevës të 12 Gushtit 1949, dhe të Nenit 4 të Protokolit II të 8 Qershorit 1977, Shtesë e Konventave të Gjenevës të 1949,

Sepse më 15 Qershor 1999, rreth orës 21.30, gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i Akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dhe në bashkëkryerje me Nazim Bllacën, të dy të veshur me rroba të zeza dhe me maska, ka hy në shtëpinë e personit civil Sali Gashi në Varigovc, Komuna Lipjan, dhe e ka vrarë atë duke përdorur armë zjarri.

I Akuzuari Hysri Rama, me shënimet personale si më lart,

SHPALLET FAJTOR

Për veprën penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale, sipas nenit 305 paragrafet 1 dhe 2 të KPK,

Sepse ai qëllimisht e ka ndihmuar Fahredin Gashin që të shmangë zbulimin në mënyrën që: më 27 Janar 2010, përpara policisë, Hysri Rama ka deklaruar që Nazim Bllaca nuk i ka treguar atij se pse ka dashtë të flas me familjen e Sali Gashit kur ata kanë shkuar së bashku në Varigovc në Qershor 2009; më 29 Tetor 2010, përpara prokurorit publik, ai ka konfirmuar atë që e ka deklaruar në një letër që i është dhënë babait të Fahredin Gashit, në të cilën ai deklaron rrejshëm, që kur ai dhe Nazim Bllaca kanë shkuar në Varigovc në 2009, Nazim Bllaca ka deklaruar që Fahredin Gashi nuk ka pasur asgjë të bëj me atë vrasje, dhe Bllaca e paraqiste Fahredin Gashin te familjarët e viktimës vetëm për të zhvatur para nga ai.

Prandaj, i Akuzuari Fahredin Gashi,

DËNOHET

Me tetëmbëdhjetë (18) vite burgim për veprën penale Krime lufte kundër popullatës civile, sipas Neneve 22 dhe 142 të KP RSFJ. Koha të cilën i Akuzuari Fahredin Gashi e ka kaluar në arrest shtëpiak prej 14 Korrikut 2010 deri më 18 Gusht 2010 dhe në paraburgim nga 19 Gushti 2010, do të llogaritet në dënim, sipas Nenit 50 Paragrafi 1 të KP RSFJ.

Prandaj i Akuzuari Hysri Rama

DËNOHET

Me gjashtë (60 muaj burgim për veprën penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale, sipas Nenit 305, paragrafet 1 dhe 2 të KPK.

Ky dënim pezullohet pasi që dënimi nuk do të ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale për një periudhë një (1) vjetore sipas Nenit 43 të KPK.

KËRKESA PASURORE-JURIDIKE

Gjykata e Qarkut në Prishtinë i udhëzon palët e dëmtuara që të paraqesin kërkesat e tyre pronësore-juridike në procedurë civile sipas Nenit 112 Paragrafi 2 i KPPK, pasi që shënimet e paraqitura në procedurën penale nuk paraqesin bazë të sigurt për një kompensim të plotë ose të pjesshëm.

SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE

Sipas Nenit 102 Paragrafi 1 dhe 3 të KPPK, Të Pandehurit do të paguajnë shpenzimet e procedurës. Sipas Nenit 100 të KPPK, pasi që mungojnë shënimet për kalkulimin e shpenzimeve të procedurës penale, më vonë do të lëshohet një vendim i veçantë mbi shumën e shpenzimeve.

ARSYETIMI

I. Historia procedurale

1. Më 5 Nëntor 2010, Aktakuza PPS nr. 460/09 – nr. 09/2010 është ngritur nga ana e PSRK në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, me të cilën Fahredin Gashi akuzohet për veprën penale krime lufte kundër popullatës civile sipas Neneve 22 dhe 142 të KP RSFJ, që aktualisht ndëshkohet sipas Neneve 23 dhe 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të përbashkët të katër Konventave të Gjenevës të 12 Gushtit 1949, dhe të Nenit 4 të Protokollit Shtesë II të Konventave të Gjenevës të 1949 të 8 Qershorit 1977, dhe Hysri Rama akuzohet për veprën penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale, sipas Nenit 305 para. 2 të KPK.
2. Seanca për konfirmim është mbajtur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë më 25 Nëntor 2010. Në vijim të zbulimit të materialeve të lëndës nga ana e PSRK-së për Mbrojtjen, Gjykatësi për Konfirmim e ka lëshuar një aktvendim me të cilin ai ka gjetur që Aktakuza PPS nr. 460/09 dhe PPS nr. 09/2010 përmbajnë informacionet e kërkuara sipas Nenit 305 para. 1 të KPPK, që Prokuroria e ka përmbushur obligimin e zbulimit sipas Neneve 307 dhe 308 të KPPK, dhe që të gjitha provat e përmendura në aktakuzë janë të pranueshme. Aktakuza është konfirmuar në tërësi me Aktvendimin KA nr. 339/2010 me datë 21 Dhjetor 2010.
3. Urdhri për caktimin e shqyrtimit gjyqësor është lëshuar më 3 Shkurt 2011. Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 15 Mars 2011.
4. Për shkak të shqetësimeve për hapësirat në dispozicion në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, Kryetari i Trupit Gjykoes ka kërkuar nga Kryetari i Gjykatës ndërrimin e lokacionit të gjykimit në një lokacion tjetër në disa raste. Pas aprovimit të Kryetarëve të Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës, disa seanca gjyqësore janë mbajtur në lokalet e Gjykatës Supreme. Më tej, më 21 Shtator 2011, Dëshmitarja Nixhare Bllaca është dëgjuar

përfundimtare. Në fillim të shqyrtimit gjyqësor sipas Nenit 366 të KPPK, duke marrë parasysh vështirësitë në lidhje me gjendjen e saj shëndetësore.

5. Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, palët janë pajtuar që Aktakuza të konsiderohet si e lexuar.² Të dy të Pandehurit janë deklaruar si të pafajshëm.³

6. Gjatë seancës së parë gjyqësore më 15 Mars 2011, i Pandehuri Hysri Rama ka hequr dorë nga e drejta e tij për ndihmën e avokatit mbrojtës dhe e ka mbrojtur vetën gjatë procedurës.⁴ Mbrojtja nuk është e detyrueshme sipas Nenit 73 të KPPK pasi që Hysri Rama është akuzuar për Dhënie të ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale sipas Nenit 305 para. 2 të KPK që dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite. Trupi gjykues e ka pranuar këtë heqje dore.

7. Më 21 Nëntor, Prokurori Special e ka paraqitur fjalën e tij përfundimtare.⁵ Palët e dëmtuara, Afrim Gashi dhe Mirvete Gashi-Hysenaj e kanë marrë fjalën.⁶ Avokati Mbrojtës Tahir Rrecaj e ka paraqitur fjalën e tij përfundimtare më 21 dhe 22 Nëntor⁷ dhe Kolë Krasniqi më 22 Nëntor.⁸ Prokurori Special bëri një kundërshtim.⁹ Palët e dëmtuara dhe Avokatët Mbrojtës bënë disa komente përfundimtare.¹⁰ Në fund, të Pandehurit Fahredin Gashi dhe Hysri Rama paraqitën fjalët e tyre përfundimtare.¹¹

8. Aktgjykimi është shpallur më 23 Nëntor 2011.

II. Kompetenca e Gjykatës dhe përbërja e Trupit Gjykues

9. Sipas Aktakuzës PPS nr. 460/09 – 09/2010, vrasja e Sali Gashit ka ndodhur më 15 Qershor 1999 në Varigovc, Komuna Lipjan, dhe vepra penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale në Prishtinë. Në pajtim me Nenin 142 të KP RSFJ, vepra penale krime lufte kundër popullatës civile “do të dënohet me burgim prej jo me pak se pesë vite ose me dënim me vdekje.”¹² Vepra penale nga Neni 305 para. 2 të KPK dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite.

10. Sipas Nenit 23 para. 1, Nenit 27 para. 1 dhe Nenit 33 para. 3 të KPPK, Gjykata e Qarkut në Prishtinë është kompetente për të gjykuar lëndën. Trupi gjykues është caktuar në pajtim me dispozitat e KPPK dhe Nenin 3 para. 7 të Ligjit mbi kompetencat.¹³

11. Në fillim të shqyrtimit gjyqësor më 15 Mars 2011, asnjë nga palët nuk ka kundërshtuar kompetencën e gjykatës e as përbërjen e trupit gjykues.¹⁴

² Lënda P nr. 371/10, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 15 Mars 2011, faqja 4

³ Ibid, faqja 10

⁴ Ibid, faqet 2-3

⁵ Lënda P nr. 371/10, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 21 Nëntor 2011, faqet 2-7

⁶ Ibid, faqja 7

⁷ Lënda P nr. 371/10, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 21 Nëntor 2011, faqet 7-8; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 22 Nëntor 2011, faqet 2-11

⁸ Lënda P nr.371/10, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 22 Nëntor 2011, faqet 11-19

⁹ Ibid, faqet 19-20

¹⁰ Ibid, faqet 21-22

¹¹ Ibid, faqet 22-25

¹² Shih gjithashtu Nenin 38 para. 1 dhe 2 të KP RSFJ

¹³ Shih gjithashtu Nenin 3 para. 1 të Ligjit nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX në Kosovë me datë 13 Mars 2008

¹⁴ Lënda P. Nr. 371/10, procesverbali i gjykimit 15 Mars 2011

III. Provat e parashtruara gjatë procedurës penale

III.A. Provat e prezantuara përpara Trupit Gjykses

12. Gjatë seancave gjyqësore, këta dëshmitarë kanë dëshmuar përpara trupit gjykses: Hyrije Gashi (vajza e viktimës)¹⁵, Afrim Gashi (djali i viktimës)¹⁶, Mirishahe Gashi (gruaja e viktimës)¹⁷, Shefkije Gashi (nusja e viktimës)¹⁸, Sejdi Gashi (vëllai i viktimës)¹⁹, Nazim Bllaca²⁰, Osman Bllaca (vëllai i Nazim Bllacës)²¹, Idriz Bllaca (babai i Nazim Bllacës)²², Mergim Bllaca (vëllai i Nazim Bllacës)²³, K.B. (kushëriri i Nazim Bllacës)²⁴, Reshat Gashi²⁵, Gani Geci²⁶, Ramiz Qeriqi²⁷, K.G.²⁸, Adem Salihaj²⁹, Metush Isufaj³⁰, Sylejman Teršana³¹, Shaban Syla³², Shpresim Uka³³, Jakup Ismaili³⁴, Musa Baftiu³⁵, Naser Bytyqi³⁶, Ajvaz Korpuzi³⁷, Hysni Arifi³⁸, Nixhare Bllaca³⁹, Nebih Avdyl Gashi⁴⁰, Sadik Abazi⁴¹, George Pleasant⁴² dhe Ibush Bllaca⁴³.

13. Më 23 Qershor Trupi Gjykses ka aprovuar kërkesën e Dëshmitarit K.B. që emri i tij mos të zbulohet. Më 5 Korrik 2011, pas kërkesës së Dëshmitarit K.G. trupi gjykses urdhëroi një seancë të mbyllur në pajtim me Nenin 329 para. 4 të KPPK. Deklarata që dëshmitari ia ka dhënë policisë më 7 Qershor 2011 është konsideruar e lexuar. Dëshmitari pastaj është

¹⁵ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Hyrije Gashit, procesverbali I gjykimit 17 Mars 2011, faqet 11-13; procesverbali I gjykimit 17 Mars 2011, faqet 2-17

¹⁶ Lënda P no. 371/10, dëshmia e Afrim Gashit, procesverbali I gjykimit 17 mars 2011, faqet 18-56; procesverbali I gjykimit 30 Mars 2011, faqet 25-29

¹⁷ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Mirishahe Gashit, procesverbali I gjykimit 22 Mars 2011, faqet 2-11

¹⁸ Lënda P. no. 371/10, dëshmia e Shefkije Gashit, procesverbali I gjykimit 22 Mars 2011, faqet 11-18

¹⁹ Lënda P.nr.371/10, dëshmia e Sejdi Gashit, procesverbali I gjykimit 22 Mars 2011, faqet 20-23

²⁰ Lënda P. no. 371/10, dëshmia e Nazim Bllacës, procesverbali I gjykimit 30 Mars 2011, faqet 3-35 (janë bërë korrigjime të versionit Anglisht të këtij procesverbali, faqet 9, 22 dhe 25) shih gjithashtu procesverbalin e 12 Prillit 2011, 13 Prillit 2011, 14 Prillit 2011 (janë bërë korrigjime në versionin Shqip të procesverbalit të datës 14 Prill 2011, faqja 22), 17 Maj 2011, faqet 2-19, 31 Maj 2011, faqet 2-28, 24 Maj 2011, faqet 2-36, 7 Qershor 2011, faqet 2-38, 6 Korrik 2011, 22 Gusht 2011 faqet 2-9

²¹ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Osman Bllacës, procesverbali i gjykimit 22 Qershor 2011, faqet 6-18

²² Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Idriz Bllacës, procesverbali i gjykimit 22 Qershor 2011, faqet 18-40

²³ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Mergim Bllacës, procesverbali i gjykimit 22 Qershor 2011, faqet 41-46 (në versionin Shqip të këtij procesverbali, "Mergim" zëvendësohet me "Naser" tri here)

²⁴ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e K.B., procesverbali i gjykimit 23 Qershor 2011, faqet 4-9

²⁵ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Reshat Gashit, procesverbali i gjykimit 24 Qershor 2011, faqet 9-26, procesverbali I gjykimit 5 Korrik 2011, faqet 2-21

²⁶ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Gani Gecit, procesverbali i gjykimit 24 Qershor 2011, faqet 2-10

²⁷ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Ramiz Qeriqit, procesverbali i gjykimit 5 Korrik 2011, faqet 21-34

²⁸ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e K.G., procesverbali i gjykimit 5 Korrik 2011, faqet 34-39 (seancë e mbyllur)

²⁹ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Adem Salihajt, procesverbali i gjykimit 6 Korrik 2011, faqet 2-11

³⁰ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Metush Isufaj, procesverbali i gjykimit 22 Gusht 2011, faqet 9-26

³¹ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Sylejman Teršana, procesverbali i gjykimit 22 Gusht 2011, faqet 26-33

³² Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Shaban Syla, procesverbali i gjykimit 23 Gusht 2011, faqet 2-36

³³ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Shpresim Uka, procesverbali i gjykimit 6 Shtator 2011, faqet 2-29

³⁴ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Jakup Ismaili, procesverbali i gjykimit 7 Shtator 2011, faqet 2-17

³⁵ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Musa Baftiu, procesverbali i gjykimit 7 Shtator 2011, faqet 27-26

³⁶ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Naser Bytyqi, procesverbali i gjykimit 7 Shtator 2011, faqet 26-37

³⁷ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Ajvaz Karpuzi, procesverbali i gjykimit 8 Shtator 2011, faqet 10-20

³⁸ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Hysni Arifi, procesverbali i gjykimit 8 Shtator 2011, faqet 3-8

³⁹ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Nixhare Bllaca, procesverbali jashtë gjykimit 21 Shtator 2011, faqet 2-7

⁴⁰ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Nebih Avdyl Gashi, procesverbali i gjykimit 29 Shtator 2011, faqet 13-16

⁴¹ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Sadik Abazi, procesverbali i gjykimit 29 Shtator 2011, faqet 3-13

⁴² Lënda P nr. 371/10, dëshmia e George Pleasant, procesverbali i gjykimit 30 Shtator 2011, faqet 25-29

⁴³ Lënda P nr. 371/10, dëshmia e Ibush Bllaca, procesverbali i gjykimit 30 Shtator 2011, faqet 2-22

marrë në pyetje. Deklarata që Nixhare Bllaca e ka dhënë në polici më 11 Gusht 2010 është konsideruar e lexuar dhe është futur në procesverbal. Ajo është marrë në pyetje nga mbrojtja më 21 Shtator 2011. Gjithashtu, deklarata e dëshmitarit Muhamet Bilali e dhënë në polici më 22 Korrik 2009 është konsideruar e lexuar dhe është futur në procesverbal.⁴⁴

14. Deklaratat e të pandehurit Hysri Rama përpara policisë më 27 Janar 2010 dhe përpara Prokurorit më 29 Tetor 2010 janë konsideruar të lexuara dhe janë futur në procesverbal. Gjatë seancës gjyqësore me 30 Shtator 2011 Hysri Rama ka deklaruar që qëndron pranë deklaratave të tij të mëparshme.⁴⁵ Deklaratat e Fahredin Gashit të dhëna te Prokurori më 13 Korrik 2010 dhe në polici më 23 dhe 27 Korrik 2007 gjithashtu janë futur në procesverbal.⁴⁶ Marrja në pyetje e Fahredin Gashit ka ndodhur më 17 dhe 21 Tetor 2011.⁴⁷

15. Trupi Gjykses shpalli të pranueshmë gjithë materialin që gjendet në dosjen e lëndës. Përpos kësaj, materiali si në vijim është administruar gjatë seancave të shqyrtimit kryesor dhe janë pranuar si prova:

- Prova 1: një fotografi me ngjyrë e shtatë personave, në pjesën e prapme gjendet data 15 qershor 99⁴⁸
- Prova 2: një fotografi me ngjyrë e dy grave dhe dy fëmijëve⁴⁹
- Prova 3: kopje e pasaportës kosovare nr. K00324678 e Frontina Gashit, lindur më 5 qershor 1999, lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme më 6 maj 2009⁵⁰
- Prova 4: skicë e logosë së SHIK-ut, skicuar nga Dëshmitari Nazim Bllaca⁵¹
- Prova 5: skicë e letërnjoftimit, skicuar nga Dëshmitari Nazim Bllaca⁵²
- Prova 6: kopje e marrëveshjes së datës 08.02.2007, nënshkruar nga Shaban Sylja, Nazim Bllaca, Shpresim Uka dhe Osman Bllaca lidhur me një veturë⁵³
- Prova 7: skicë e një liste prej krimeve të kryera, skicuar nga Dëshmitari Nazim Bllaca⁵⁴
- Prova 8: kopje e një fotografie të dy personave, përmban numrat 11:0; dhe 18.8.1998⁵⁵
- Prova 9: një faturë origjinale e Raiffeisen Bank, datuar 12 shtator 2006, transaksioni nr. TT0625505993⁵⁶
- Prova 10: një kopje me ngjyrë e Shpalljes së Demobilizimit të Dëshmitarit Nazim Bllaca, në gjuhën shqipe, datuar 22 nëntor 1999⁵⁷

⁴⁴ Lënda P nr. 371/10, procesverbali i gjykimit 29 Shtator 2011, faqet 17

⁴⁵ Lënda P nr. 371/10, procesverbali i gjykimit 30 Shtator 2011, faqet

⁴⁶ Lënda P nr. 371/10, procesverbali i gjykimit 29 Shtator 2011, faqja 17; procesverbali i gjykimit 30 shtator 2011, faqja 15 për Fahredin Gashin; procesverbali i gjykimit 21 tetor 2011, faqja 20 për Hysri Ramën

⁴⁷ Marrja në pyetje e Fahredin Gashit, procesverbali i gjykimit 17 Tetor 2011, faqet 21-31; procesverbali i gjykimit 21 Tetor 2011, faqet 2-18

⁴⁸ Lënda P nr. 371/10, procesverbali i gjykimit 12 prill 2011

⁴⁹ Lënda P nr. 371/10, procesverbali i gjykimit 14 prill 2011

⁵⁰ Ibid

⁵¹ Ibid

⁵² Ibid, faqe 23; shënon: 'korniza e kartelës është me ngjyrë të zezë të theksuar. Në pjesën e epërme është logoja e UÇK-së dhe pastaj ajo KLA, pastaj numri i selisë, titulli është leja e udhëtimit, përmbajtja është "Nazim Bllacës nga Ribari i Madh i lejohet të udhëtojë në gjithë territorin e Kosovës' dhe pastaj në fund është emri Agim Ceku."

⁵³ Ibid

⁵⁴ Ibid

⁵⁵ Ibid

⁵⁶ Lënda P nr. 371/10, procesverbali i gjykimit 31 maj 2011

⁵⁷ Lënda P nr. 371/10, procesverbali i gjykimit 22 qershor 2011

- Prova 11: origjinali i letrës së datuar 12 janar 2001 nga Dr. Jakub Ismajli në gjuhën shqipe, nënshkruar dhe vulosur⁵⁸
- Prova 12: origjinali i CD-së datuar 13 tetor 2009, quajtur "inçizimi Nazim Bllaca"⁵⁹
- Prova 12bis: origjinali i DVD-së datuar qershor 2008, quajtur Nazim Bllaca dhe familja në shtëpinë e Hysri Ramës⁶⁰
- Prova 13: dy fatura origjinale bankare të Raiffeisen Bank, datuar 7 qershor 2006, numri referues i transakcionit TT0618800838 dhe numri referues i transakcionit TT0618800915⁶¹
- Prova 14: kopje e kontratës origjinale për shitjen e pronës në gjuhën shqipe, datuar 29 qershor 2006 lidhur në mes të Nazim Bllacës për Habib Cakën dhe Fahredin Gashit, certifikuar nga avokati Ramiz Krasniqi (tre faqe)⁶²
- Prova 15: skicë e rrugës që pretendohet se ka ndjekur më 15 qershor 1999 (Shtime, Lipjan, Qylage, Shala, Kroimir dhe Pjetershtice, et.) nga Dëshmitari Reshat Gashi⁶³
- Prova 16: origjinalet e dy raporteve në gjuhët angleze dhe shqipe nga Policia e EULEX-it, Njësia Hetimore për Krim të Organizuar, një nën dosjen numër OCIU/12/20110727/2447, lënda nr. PPS 09/2010 datuar 27 korrik 2011; një nën dosjen numër OCIU/12/20110926/2658, lënda numër PPS 460/09-09/2010 datuar 26 shtator 2001.⁶⁴

16. Si në vijim, prokurori dorëzoi deklaratat e dëshmitarit Trupit Gjykues si dhe pajisi mbrojtjen me to: procesverbali origjinal i seancës dëgjimore me dëshmitarin Idriz Bllaca para Prokurorit më 6 qershor 2011 në versionet angleze dhe shqipe,⁶⁵ origjinali i procesverbalit të seancës dëgjimore me Dëshmitarin K. G. Para policisë, datuar 7 qershor 2011, versioni anglisht dhe ai shqip;⁶⁶ origjinali i procesverbalit të seancës dëgjimore me dëshmitarin Musa Baftiute Prokurori, datuar 22 qershor 2011, versioni anglisht dhe ai shqip;⁶⁷ origjinali i procesverbalit të seancës dëgjimore me dëshmitarin Jakup Ismaili të Prokurorit, datuar 22 qershor 2011, versioni anglisht dhe ai shqip;⁶⁸ origjinali i procesverbalit të seancës dëgjimore me dëshmitarin Reshat Gashi te Prokurori, datuar 22 qershor 2011;⁶⁹ origjinali i procesverbalit të seancës dëgjimore me dëshmitarin Naser Bytyqi para Prokurorit, datuar 14 qershor 2011, versioni anglisht dhe shqip;⁷⁰ kopje e procesverbalit të dy seancave dëgjimore me Dëshmitarin Metush Isufaj te Prokurori, datuar 16 dhe 21 shkurt 2011, versioni anglisht dhe shqip;⁷¹ kopje e origjinalit të procesverbalit të seancës dëgjimore me dëshmitarin Sylejman Terhani te Prokurori, datuar 21 shkurt 2011, versioni anglisht dhe shqip;⁷² kopje e procesverbalit të seancës dëgjimore me Dëshmitarin Hysni Arifi te Prokurori, datuar 19 korrik 2011, versioni anglisht dhe shqip;⁷³ kopje e procesverbalit të seancës dëgjimore me Dëshmitarin Ibush Bllaca te Prokurori, datuar 20 korrik 2011, versioni anglisht

⁵⁸ Ibid

⁵⁹ Ibid

⁶⁰ Ibid

⁶¹ Ibid

⁶² Lënda P nr. 371/10, procesverbali i gjykimit, 22 qershor 2011, faqe 4-5

⁶³ Lënda P nr. 371/10, procesverbali i gjykimit 5 korrik 2011, faqe 20

⁶⁴ Lënda P nr. 371/10, procesverbali i gjykimit 30 shtator 2011

⁶⁵ Lënda P nr. 371/10, procesverbali i gjykimit 22 qershor 2011

⁶⁶ Lënda P nr. 371/10, procesverbali i gjykimit 23 qershor 2011, faqe 3

⁶⁷ Ibid

⁶⁸ Ibid

⁶⁹ Ibid

⁷⁰ Ibid

⁷¹ Lënda P nr. 371/10, procesverbali i gjykimit⁵ July 2011

⁷² Ibid

⁷³ Lënda P nr. 371/10, procesverbali i gjykimit⁶ September 2011, faqe 3

dhe shqip;⁷⁴ dhe kopje e procesverbalit të seancës dëgjimore me dëshmitarin Muhamet Bilalli te policia, datuar 22 korrik 2009, versioni anglisht dhe shqip.⁷⁵

17. Trupi Gjykses pranoi nga PTK-ja një CD më 23 qershor 2011. CD-ja përmban mesazhe tw nxjerra nga numri i telefonit 044 112 864 për periudhat kohore në mes të 20.07.2007 deri më 25.11.2007 dhe nga 12.05.2009 deri më 31.12.2009. Më 6 korrik 2011, Dëshmitari Nazim Bllaca dorëzoi dokumentacionin mjekësor të Dëshmitarit Nixhare Bllaca, datuar 19 qershor 2010.

18. Më 21 tetor 2011, Prokurori Special i prezantoi Trupit Gjykses si në vijim: kryerja e demilitarizimit dhe transformimit të UÇK-së, datuar 20 qershor 1999, versioni anglisht, dhe brifingu i NATO-së nga mëngjesi, datuar 17 qershor 1999, versioni anglisht. Më 22 nëntor 2011, Prokurori Special i dorëzoi Trupit Gjykses Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/66 datuar 21 dhjetor 2000.

19. Faza e provave përfundoi më 26 tetor 2011.

III. B. Deklaratat e të pandehurve Fahredin Gashi dhe Hysri Rama

Dëgjimi i të dyshuarit Fahredin Gashi⁷⁶

20. Fahredin Gashi deklaroi se më 23 dhjetor 1998 është plagosur në një pritë dhe është mjekuar në fshatin Petrove; pastaj ka vepruar si udhëheqës i qendrës së trajnimit në fshatin Pjtershtice. Ai poashtu ka thënë se më 2002-2003, Hysri Rama e kërcënoi atë se do ta raportonte në polici dhe pas një muaji, kërcënimi ndaloi. Ai poashtu tha se Burim Hyseni e kërcënoi atë si dhe sërish Hysri Rama më 2005.

Dëgjimi i Fahredin Gashit⁷⁷ në bazë vullnetare

21. Fahredin Gashi deklaroi se: gjatë një takimi në mes të Nazim Bllacës, Hysri Ramës dhe një personi të tretë më 25 korrik 2007, Nazim tha “ne vetëm e kemi provokuar, ose do t’japë të hollat ose do t’ia q nënën dhe ta dërgojmë në pyll”. Nazim Bllaca kishte planifikuar t’a rëmbente atë dhe shefin e tij dhe kërkoi dy milionë haraç dhe poashtu përgatiti grabitjen e Kasabank. Fahredin Gashi i ka dhënë numrat e telefonit që janë përdorur për t’a kërcënuar. Ai deklaroi se në mars 2007, pasi Hysri Rama i kishte kërkuar 400.000 Euro, Gashi shkoi t’a takonte të shoqen e Nazimit; Fahredin Gashi poashtu foli edhe me Idriz Bllacën; ai takoi Nazimin, i cili i kishte thënë se i duheshin të hollat për të paguar borxhe, por Gashi refuzoi t’a ndihmonte. I pandehuri tha se nuk e kishte raportuar këtë në polici ngase Nazim Bllaca akoma i ka borxh 150.000 Euro. Sipas Fahredin Gashit, ai asnjëherë nuk ka pasur keqkuptime me Nazim Bllacën para marsit 2007; ai dhe Nazimi ka katër apo pesë vjetë që nuk janë takuar; ai asnjëherë nuk ka punësuar dikë për të vrarë Nazimin. Ai tha se ka pasur një AK 47 dhe një revole TT që i janë marrë nga KFOR-i më 12 qershor 1999.

Dëgjimi i Fahredin Gashit⁷⁸

⁷⁴ Ibid

⁷⁵ Lënda P nr. 371/10, procesverbal i gjykimit²⁹ September 2011, faqe 17

⁷⁶ Hearing of Suspect Fahredin Gashi before the police dated 23rd July 2007

⁷⁷ Volunteer hearing of Fahredin Gashi before the police dated 27th July 2007

⁷⁸ Dëgjimi i të pandehurit Fahredin Gashi te Prokurori Publik, datuar 13 korrik 2010

22. I pandehuri deklaroi se nuk ka qenë i përfshirë në veprat penale të përshkruara në aktakuzë. Ai përmendi se Nazim Bllaca i kishte dërguar ca mesazhe SMS në maj apo qershor 2007 dhe se në ato përmendej Sali Gashi. Ai kishte takuar Bllacën gjatë luftës. Fahredin Gashi deklaroi se ka qenë i burgosur që nga 25 qershori deri më 7-8 korrik 1998 sepse duke qenë biznesmen, ai ka pasur ca lidhje me serbët. Pastaj në mes të korrikut 1998, ai i është bashkangjitur Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe është demobilizuar më 12 qershor 1999. Ai ka qenë në fshatrat Petreshtica dhe Krohimir, Brigada 121, Batalioni II. Komandanti i Batalionit ishte Elez Durmish ndërsa komandanti i brigadës ishte Haxhi Shala. Ai ka bartur uniformë deri më 25 dhjetor 1998. Pas kësaj, është marrë me dërgimin e ushqimit të burgosurve dhe asnjëherë nuk ka qenë i përfshirë në vetë luftimet. Ai kishte pasur një AK-47, e cila është konfiskuar nga KFOR-i më 12 qershor 1999. Pastaj shkoi në Prishtinë dhe filloi të merrej me biznes. Ai nuk e din a ka qenë Nazim Bllaca ushtar, mirëpo e ka parë në uniformë si dhe në rroba civile.

23. Ai tha se ka pasur marrëdhënie të mira biznesi me Nazim Bllacën. Ai tha si në vijim: më 12 shtator 2006 është arritur një marrëveshje verbale për të blerë një tokë prej 220.000 Euro nga Bllaca, i cili po vepronte si ndërmjetës. Ai i ka dhënë 150.000 Euro para të gatshme Bllacës, por ky i fundit kurrë nuk e kreu transferin e dokumenteve për blerjen e tokës, prandaj, ai i ka borxh Gashit 150.000 Euro. Fahredin Gashi kërkoi nga ai të bëjë transferin e tokës disa herë deri më 25 mars 2007. Pastaj Bllaca dërgoi Hysri Ramën te Fahredin Gashi për të kërkuar 400.000 Euro, përndryshe, ata do të raportonin në gazeta për çdo vrasje që është kryer që nga viti 1999. Ai tha se Nazim Bllaca, babai i tij si dhe dy vëllezërit e tij filluan t'a shantazhonin dhe t'a kërcënonin atë. Madje, Bllaca i kishte treguar edhe një CD të intervistimit të tij në Hagë për hetimin e Limajt duke kërkuar 3 milionë Euro për të mos e bërë CD-në publike.

24. I pandehuri deklaroi se më 25 mars kishte shkuar te Bllaca. Të pranishëm kishin qenë Reshati, Azemi, Asllani, Hysri Rama, Shpresim Uka, Sherif Salihu, Idriz Bllaca dhe dy vëllezërit e Nazimit. Ai përmendi se Idriz Bllaca tha se Nazim Bllaca kurrë nuk do të bënte një gjë të tillë, por prap, kërkoi 400.000 Euro deri të hënën; ata i thanë se nuk do t'i jepnin të holla dhe u larguan. Nazim Bllaca i dërgoi SMS duke thënë se do t'i bënte 40 vjetë burg dhe shkroi emrat e 10 njerëzve që pretendon se Fahredin Gashi i kishte vrarë. I pandehuri Gashi deklaroi se Nazim Bllaca shkoi në polici për të thënë se Gashi kishte vrarë Adem Lahun, edhe pse në DVD Nazim Bllaca kishte thënë se dikush tjetër e kishte vrarë. Ai tha se nuk e ka parë Bllacën që nga viti 2007.

25. Fahredin Gashi sqaroi lidhur me shënimet e gjetura në kopjen e fletores së gjetur në shtëpinë e tij gjatë bastisjes së kryer më 13 korrik 2010. Është kjo një liste me persona që i kanë borxh të holla: nën datën e premtë, 4 janar, është e shënuar me shkrim dore Nazim Bllaca (150.000); Daja, nofka e Azem Sylës (20.000); Hysri Rama (43.260 Euro). Një copë letër e vetme ka të bëjë me blerjen e dy banesave me shitësit Shaban, Shpresim dhe Sherif Salihu (Papaqi: Driton Hajdari).

26. Ai përmendi se ka raportuar shantazhimet e Bllacës në policinë e Prishtinës, dhe deklaroi se emrin Sali Gashi e njeh që nga mesazhet SMS të Bllacës; por se ka dëgjuar për vrasjen e tij ditën e seancës. Përfundimisht, Fahredin Gashi deklaroi se ai është anëtar i LDK-së dhe jo anëtar i Shërbimit Informativ Kombëtar.

Marrja në pyetje e të pandehurit Fahredin Gashi në gjykatë

27. Gjatë shqyrtimit kryesor, i pandehuri deklaroi se ka qenë i përfshirë në biznes që nga viti 1990: fillimisht me tekstile dhe ushqim dhe që nga viti 1996, me material ndërtimor. Ai ka takuar Nazim Bllacën në fund të luftës, më 12 qershor. Fahredin Gashi kishte dëgjuar se Bllaca ishte në Blinaje. Ai përmendi se këto njësi të batalioneve të UÇK-së janë themeluar pas sulmit të parë (25 korrik 1998) apo të dytë (25 gusht 1998).

28. Ai tha se në fund të vitit 1998 ai ka punuar me të rinjt e Pjetershticës për të copëtuar trungje drunjsh për lëndë djegëse, sjellja e ushqimit ushtarëve dhe se ka vazhduar deri më 11 qershor 1999. Gjatë vitit 1998, ai ka bartur armë dhe më 1999 ka pasur një revole dore dhe ka dhënë pushkën e tij, një AK-47 të Shqipërisë, qytë të drunjt, një ushtari. Më 11 qershor, e mori sërish armën nga ushtari. Ai përmendi se është plagosur më 23 dhjetor 1998 derisa po shkonte në fshatin Godancv, plaga në pulpën e këmbës nuk ishte e rëndë dhe është ndaluar në fshatin më të afërm, Belince, në mënyrë që disa vajza t'i pastronin plagën dhe pastaj vazhdoi për në Pjetreshitce.

Marrëdhënia me Nazim Bllacën

29. Më 2001, filloi të bënte marreveshje pronësore me Nazim Bllacën deri më shtator 2006. Bllaca i shiste pronat më lirë se sa që do t'i kishte blerë ai dhe ai shpenzoi një shumë të madhe të hollave për gra; ai u merrte depozita njerëzve dhe dështonte për të transferuar pronën dhe për t'u kthyer të hollat. Më 12 shtator 2006, Bllaca mori depozitën prej 150.000 Euro Gashit dhe asnjëherë nuk transferoi pronën; Bllaca nuk kishte të holla për t'u paguar pronarëve. Shumë e përgjithshme e marrëveshjes ishte 228.000 Euro. Fahredin Gashi insistoi që të kryhej transferi i tokës, por më 24 Mars, Bllaca i ndali të gjitha telefonët dhe filloi të shantazhonte dhe të kërcënonte. Nazimi e telefonoi duke i kërkuar 2,500 Euro "sepse nuk po largohen nga shtëpia ime". Fahredin Gashi fillimisht refuzoi, por pasi që e thirri e shoqja e Nazim Bllacës, atij i erdhi keq për gruan dhe i dha të hollat.

30. Më 24 mars 2007, Hysri Rama takoi Fahredin Gashin në Restorantin Motrat Binjake për t'i dhënë porosinë e Nazim Bllacës se Gashi kishte kohë deri të hënën në 16:00 për të depozituar 400,000 Euro, përndryshe Gashi dhe familja e tij do të vuanin pasojat. Që ditën e njëjtë, Gashi ndaloi në Lipjan, në shtëpinë e gruas së Nazimit. Ai poashtu shkoi edhe në shtëpinë e Idriz Bllacës me Reshat Gashin, Azem dhe Asllan Bllaca, Shpresim dhe Sherif dhe Idriz i kanë thënë "duhet të na sjellësh të hollat deri në hënën. Nëse këto të holla kanë të bëjnë me reket apo haraç, do t'i këpus kokën Nazimit dhe fëmijëve të tij".

31. Një herë Fahredin Gashi dërgoi K.G. te Idriz Bllaca për të mbyllur këtë punë. Sipas deklaratës së Fahredin Gashit, ai pranoi 400 SMS nga Nazim Bllaca dhe nuk i është përgjigjur. Hera e fundit që takoi Nazimin ishte më 26 mars 2007. Kishte kërcënime të ndryshme ndaj tij dhe fëmijëve të tij; Nazim Bllaca kishte thënë se çdo vrasje e pazgjidhur që ishte kryer pas luftës do t'i atribuohet Gashit (Adem Rusinovci, në fakt Adem Lahi) dhe vazhdoi të dërgojë SMS me emra të personave të ndryshëm; se do të botonte CD-të e intervistimit të Gashit nga hetuesit e Hagës më 2004 në shkëmbim për 3 milionë Euro; Nazim Bllaca dërgoi disa persona për të kërkuar të holla (Muhamed Bilalli, Ijas Korksi, Shaban Sylla, etj.)

32. Fahredin Gashi i është referuar numrave të përdorur (044 671800, 044 206449, 044 779049, 044819782, 044821565) dhe deklaroi se ka pranuar SMS edhe nga një numër i Maqedonisë. Ai i transferoi SMS-at e pranuar policisë.
33. Fahredin Gashi tha se nuk ka pasur kamatë me rastin e huadhënies së të hollave dhe se ai vazhdimisht dhuron të holla për bamirësi. Më 2005, Nazim Bllaca u shiti njerëzve një shtëpi me dokumente të falsifikuara dhe për shkak të presionit, Bllaca pësoi hemoragji cerebrale, e cila e la pa vetëdije për tre ditë dhe të palëvizshëm për tre muaj.
34. I pandehuri tha se SMS-i i parë që pranoi ishte më 24 mars 2007 në 15:00: "nuk mund të shihemi më". I dyti kërkonte transferin e 400,000 Eurove deri të hënën në llogarinë e tij bankare. Më 26 mars, me kërkesën e Bllacës, ata u takuan në Elez Han për herë të fundit dhe këtu, Bllaca përsëriti kërkesën e tij. Më 28 mars, Bllaca dërgoi Fatmir Prapashticën për të kërkuar të holla; dhe pastaj Shpresim Uka, Shaban Sylja dhe Limon Bllaca më 2007. Më 2009, Fahredin Gashi së pari dërgoi Reshat Gashin, pastaj Muhamet Billalin, Ajvaj Karpuzin dhe pastaj anëtarët e familjes së tij.
35. Fahredin Gashi deklaroi se ishte në marrëdhënie biznesi me Shaban Sylën, i cili kishte probleme me Nazim Bllacën. Ky i fundit i kishte të holla borxh Shpresim Ukës dhe personave të tjerë (Agim Kastrati, Isak Thaci, Muhammad Bllaca, Bedri Qorolli, Isak Ademi).
36. Për më tepër, ai deklaroi se kishte qenë anëtar i LDK-së para lufte dhe se tanimë është anëtar i Odws Ekonomike të Kosovës.
37. Prokurori Special i është referuar deklaratës së mëparshme të Gashit, datuar 13 korrik 2010 duke thënë 'përndryshe do t'u raportojmë gazetave çdo vrasje që është kryer nga viti 1999' dhe solli në pah kundërshtimet lidhur me kërcënimin dhe me përfshirjen e pretenduar të drejtpërdrejtë të Hysri Ramës kur thotë 'ne'. Fahredin Gashi sqaroi "po, nuk e di si e ka kuptuar atë, por kur ka thënë se do të vuajë pasojat, se do t'ë raportojë te gazetatat për personat e vrarë dhe anëtarët e familjes dhe se do të më akuzojë si kryerës i këtyre vrasjeve, kjo në fakt është pasojë dhe në fakt, unë tanimë po i vuaj këto pasoja dhe është e vërtetë se i ka thënë këto fjalë."
38. Fahredin Gashi deklaroi se Shaban Sylja dhe Shpresim Uka nganjëherë i kishin të holla borxh dhe se Sadik Abazi i kishte 12,000 Euro borxh.

Alibia

39. Fahredin Gashi tha se me të përfunduar lufta më 9 qershor 1999, ushtarët janë tërhequr nga pozicionet e tyre më 11 qershor dhe ai i liroi të gjithë civilët dhe është kthyer në shtëpi; më 11 qershor, familja e tij shkoi në shtëpi nga Gryka e Krujmirit. Ai hipi në një traktor që po bartte refugjatë dhe këtë e ngiste Nazim Bllaca dhe shkoi në fshatin Godanc; më 12 dhe 13 qershor 1999, ai ishte në Prishtinë; më 13 qershor, është kthyer në Shtime, ku është ndaluar nga KFOR-i britanez dhe i është konfiskuar arma e dorës. Ai kishte qenë në një situatë të vështirë: gjyshërit i kishte të sëmure, gruaja e tij kishte filluar lindjes e fëmijës më 5 qershor dhe fëmija i posalindur ishte i dehidruar, kishte telashe që të ushqente fëmijët.
40. Ai deklaroi se më 14 dhe 15 ishte në shtëpi dhe pasditë shkoi në shtëpinë e Hysni Arifit. Në trekëndëshin e Shtimes derisa po kërkonte ushqim për të bijën e posalindur, ai takonte personelin mjekësor (Naser Bytyqi, Jakup Ismajli, Reshat Gashi, Musa Baftiu dhe

Ajvaz Karpuzi) pasdite. Ai e pranoi se “nuk më kujtohet ora.” Ai hipi në veturën e tyre për të shkuar në shtëpinë e Hysni Arifit. Kur është pyetur se sa gjatë qëndroi aty, ai u përgjigj “nuk më kujtohet, por siç shkojnë këto punë, filluam të pinim, të hanim dhe pastaj është bërë kohë e gjatë.” Vazhdoi duke thënë se “ishte pasdite e vonë kur filluam të shkonim. Shkuam në dy drejtime, disa në shtëpinë e Naserit dhe disa dikund tjetër. Hysniu mori Jakupin në fshatin Lloshkobare. Unë nuk shkova me asnjërin prej tyre. U nisa në këmbë. [...] kur iu afrova Shtëpisë së Mallërave në Shtime, Shoqata Nëna Terezë po shpërndante ca gjëra, fatkeqësisht ishin gjëra plastike. KFOR-i më dha ca çokollata dhe u nisa për në shtëpi. Tanimë ishte errësuar.”

41. Ai deklaroi se fotografia⁷⁹ është bërë në pasditën e vonshme të datës 15 qershor nga gruaja e Hysni Arifit me kamerë të Naserit. Ai tha se në atë kohë ka peshuar 46 kg. Në pyetjen e Prokurorit Special se pse nuk ka përmendur se në pasditën e 15 qershorit 1999, ka qenë në shtëpinë e Hysni Arifit, Fahredin Gashi u përgjigj duke thënë “sepse asnjëherë nuk më keni shtuar pyetje të tillë, gjithnjë më ka pyetur avokati për rastet e vrasjeve dhe rrethanat e tilla ndërsa ju gjithnjë më keni pyetur për biznes dhe për të holla [...]”.

42. Fahredin Gashi tha se Nazim Bllaca doli haptazi, Nazmije Hysenaj, ish-ushtarë erdhi në zyrën e tij dhe i tha se Sali Gashi ishte daja i saj dhe e pyeti për arsyen pse po përmendej emri i Sali Gashit; ai i sqaroi asaj njëjtë siç sqaroi edhe në gjykatë. Kur është pyetur se pse refuzoi të takohej me të afërmit e viktimës, Gashi iu përgjigj duke thënë se ata kanë qenë në shtëpinë e babait të tij në Shtime dhe se Gashi letonte në atë kohë në Prishtinë; se babai i tij nuk dinte gjë për shantazhimet e Nazim Bllacës dhe se tre ditë më vonë, e ëma e tij i tregoi për vizitën dhe menjëherë Gashi shkoi në Stacion të Policisë, dhe erdhën për të marrë deklaratën e babait të tij. Myrvete Hysenaj përmendi se Nazmija asnjëherë nuk kishte thënë se kishte pasur bisedë me Fahredin Gashin.

Deklarata e Hysri Ramës⁸⁰

43. Hysri Rama deklaroi se ka qenë ndërmjetës për blerjen e një tokë dhe se ka pranuar 40.000 Euro për shitjen, Fahredin Gashi ishte blerësi. Pasi që dokumentet dolën të falsifikuara, Fahredin Gashi paditi Hysri Ramën në gjykatë. Rama tha se i ka kthyer Gashit të hollat dhe dy vetura. Pas çështjes së shitjes së tokës, ai kurrë më nuk kishte takuar Gashin. Ai poashtu tha se është zënë në pritë më 17 shtator 2004.

44. Ai deklaroi se gjatë luftës kishte qenë afër me Shaban Sylën dhe Nazim Bllaca ishte afër me Shabanin dhe Shpresim Ukën dhe se ka takuar Bllacën pas lufte. Ai poashtu ka thënë se kurrë nuk ka qenë te Bllaca për t'a paralajmëruar se njerëzit po përpiqeshin t'a vrisnin.

45. Në pyetjen se a ka qenë ndonjëherë me Nazim Bllacën në fshatin Varigovc, Rama tha “Po, mendoj se ishte më 2009 kur shkuam në një familje. Unë e kam vozitur Nazimin aty me veturën time Jeep Grand Cherokee dhe ai ka biseduar me ca anëtarë të familjes derisa unë kam qëndruar ulur në veturë. Ai nuk më tha arsyen pse dëshiron të bisedojë me atë familje dhe unë nuk kam dëgjuar bisedën ngase isha rreth 15 - 20 metra larg tyre. Dhe nuk kam qenë i interesuar për të kuptuar pse po fliste me ata njerëz.”

⁷⁹ Prova nr. 1

⁸⁰ Deklarata e Hysri Ramës në polici më 27 janar 2010

46. Ai përmendi edhe një takim me Nazim Bllacën më 2009: Rama tha se Nazimi u largua nga Kosova më 2007 për shkak se i kishte të holla boxh ca njerëzve dhe se ka ardhur në shtëpi të Ramës dhe ka qëndruar disa ditë; Rama i thirri të afërmit e Bllacës për të zgjedhur çështjen që Bllaca kishte me ta; dhe babai dhe vëllezërit e Bllacës erdhën në shtëpinë e tij. Ai deklaroi se familja nuk dëshironte që Nazimi të kthehej për shkak të borxheve, por eventualisht pranuan të kenë kontakt me ta. Ai deklaroi se “unë kurrë nuk kam marrë të holla nga Shaban Sylja për të vrarë Nazim Bllacën”. Për më tepër, ai tha se Bllaca kishte punë me prona dhe merrej me para, por harxhonte mjaft me gra.

47. Rama tha se pasi qw Bllaca doli haptazi, ai ka dhwnw njw intervistw gjatw sw cilws ka mohuar akuzat. Ai e thirri Nazimin, por nuk ka mundur tw takohej. Mw vonw, Nazim Bllaca ka dhwnw njw audio-inccizim me zw tw Ramws; dhe Hysri Rama swrish doli nw media duke thwnw se ishtw zwri i tij nw inccizim, por inccizimi ishte montazhw.

48. Gjatw intervistimit tw tij, ai wshtw informuar se pasi qw “ka indikacione se Hysri Rama wshtw duke fshehur informata dhe se nuk e thotw tw vwrтетwn pwr fakte pwr tw cilat ai wshtw nw dijeni, ai pengon drejtwsinw dhe prandaj ai wshtw informuar se tani e tutje, ai do tw konsiderohet i dyshuar”. Hysri Rama nuk ka shfrytwzuar tw drejtwn e tij pwr tw qwndruar nw heshtje dhe pwr tw pasur avokat.

49. I pandehuri Rama tha se: shuma prej 100.000 Euro e përmendur në inçizim mund të ketë të bëjë me shitjen e tokën që i takonte Gashit, dhe pjesa që ka të bëjë me 3000 apo 4000 Euro me shpenzimet e veturës së tij Jeep. Ai insiston se Bllaca i ka bërë disa inçizime dhe i ka bashkuar të gjitha së bashku derisa ka punuar me prokurorët serbë në Serbi, ku është mësuar të bëjë montazhë. Nazim Bllaca i ka thënë se ka pranuar CD me dëshmi të dhëna nga Fahredin Gashi dhe dëshmitarëve të mbrojtur në Hagë në lëndën e Limajt nga një prokuror në Serbi dhe se Nazim Bllaca shantazhoi Gashin duke i thënë se do të bënte publike dëshminë nëse nuk i jep 3 milionë Euro. Sipas Hysri Ramës, Nazim Bllaca tha se kishte informata lidhur me zhdukjen e nipit të Shaban Sylës më 1997 dhe se kërkonte të holla në shkëmbim me detale të tjera. Ai poshtu tha se Nazim Bllaca deshi të shkonte te Shabani për të kërkuar të holla nga Gashi duke i dërguar një kopje të CD-së.

50. Ai deklaroi se Shabani i kishte dhënë të holla disa herë borxh dhe se marrëdhënia në mes tw Nazimit dhe Shabanit ishte e mirë derisa Bllaca doli haptazi. Hysri Rama mohoi të ketë pasur kontakt me Bllacën nëpërmjet internetit.

51. Ai iu referua takimit të mbajtur më 13 tetor 2009: Nazimi i ka të holla borxh Shabanit (84.000 Euro) dhe Shpresimit (22.000 Euro), prandaj Nazim Bllaca dhe Hysri Rama ftuan për takim Shpresimin. Nipi i Ramës poashtu ishte i pranishëm. Shpresimi erdhi me Qazim Shabanin në shtëpinë e Ramës dhe i ofroi ndihmë Bllacës.

Seanca dëgjimore e Hysri Ramës⁸¹

52. Gjatë seancës, Hysri Ramës iu tregua një letër me shkrim dhënë mbrojtjes.⁸² Ai deklaroi se kishte shkruar letrën me vetë-iniciativë Haradin Gashit, babait të Fahredin Gashit “sepse ndieja obligim t’u tregoja se çfarë më kishte thënë Nazim Bllaca”; dhe tha “të gjitha që i kam shkruar i kam dëgjuar nga Nazim Bllaca”. Prokurori Special përkujtoi Ramën për

⁸¹ procesverbal i Hysri Ramës te Prokurori më 29 tetor 2010

⁸² Bashkangjitur procesverbalit të intervistimit të Nazim Bllacës, datuar 25 tetor 2010

dëshminë e tij të dhënë më 27 janar 2010 lidhur me vizitën e tij në Varigovc me Bllacën në 2009. Hysri Rama tha se e vërteta gjendet në letër se “pas disa dite, Bllaca më tha se çfarë kisha shkruar në letër, pra që Fahredini nuk ishte përgjegjës dhe se ai vetëm donte t’i zhvaste të holla”. Ai deklaroi se fillim, Nazim Bllaca nuk sqaroi çdo gjë detalisht. Prokurori informoi dëshmitarin se do të zgjeronte hetimin që po zhvillohej kundër Gashit për të përfshirë atë dhe se që tani e tutje, ai është i pandehur në këtë lëndë.

IV. Gjetjet e Gjykatës së Qarkut

IV.A. Vrasja e Sali Gashit sipas deklaratave të dëshmitarit bashkëpunues Nazim Bllaca

53. Dëshmitari Nazim Bllaca dëshmoi në gjykatë si në vijim:

54. Më 14 qershor 1999, Fahredin Gashi i tha të shkonte në shkollën fillore në fshatin e Pjetershticës. Më 15 qershor 1999, u takuan aty rreth orës 21.00. Ai deklaroi se duheshin rreth 30-40 minuta për të arritur nga Pjetershtica në Varigovc, por nuk e ka verifikuar këtë. Fahredin Gashi tha “do të shkojmë dhe të marrim një njeri në pyetje jashtë shtëpisë së tij”. Ata u nisën për në fshatin Varigovc.

55. Me të arritur në vend, para se te trokisnin në derën e vëllait të viktimës, Fahredin Gashi i tha se po e kërkonin Sali Gashin. Ata u futën në shtëpinë e vëllait të Sali Gashit dhe e kapën atë. E pyetën “ku është shtëpia e Sali Gashit?” dhe ai u tha “më andej”. Që të tre ecën në atë drejtim dhe iu afruan derës. Vëllai u tha “kjo është shtëpia; por mos më vëni në pozitë të keqe”. Dëshmitari Bllaca përmendi se i vëllai ishte i frikësuar. Vëllai e thirri Saliun me emër dhe pastaj Fahredin Gashi dhe Nazim Bllaca e larguan. Një grua e hapi derën dhe i pyeti “çfarë kërkon?” Ata insistonin ta kuptonin se ku ishte Saliu. Dy persona të tjerë ishin më poshtë në korridor. Fahredin Gashi hyri i pari. Nazim Bllaca deklaroi se mbase e ka shtyrë gruan.

56. Që të dy kishin me vete automatikë Kalashnikovë, Fahredin Gashi kishte një të shkurtër ndërsa Nazimi të gjatë, shqiptare, qw mund t’i vendosej mortaja, me qytw tw drunj. Kishin me vete edhe municion, bomba dhe disa plumba. Kishin vënë maska të zeza dhe rroba të zeza. Bllaca nuk kishte vënë dorëza.

57. Ata pyetën se ku po qëndronte Sali Gashi dhe menjëherë u futën në dhomë, dhoma e parë në të majtë ku ishte viktimja. Fahredin Gashi hyri i pari. Bllaca tha se Sali Gashi rastisi të jetë aty sepse ishte dera e vetme gjysëm e hapur. Tre njerëz, dy femra dhe një mashkull ishin në korridor. Viktimja, gjysëm i fjetur, po qëndronte i shtrirë në divan. Ana e djathtë, me shpinë për muri. Ata iu afruan dhe Fahredin Gashi i tha “eja me ne”. Edhe Nazimi tha “eja me ne” dhe “nuk kemi kohë – shkojmë”. Bllaca ka mundur të ketë qenë dy hapa brenda në dhomë, viktimja ra nga divani dhe tha “jam i sëmurë, nuk mund të vij”.

58. Fahredin Gashi ka shtënë në Sali Gashin duke e drejtuar armën në pjesën e epërme të trupit, në veçanti në kokë, duke shtënë me rafalle tw shkurtwra me armë automatike. Ai aktivizoi armën një herë apo më shume se një herë. Pasi që është shtënë, viktimja ra në dysheme. Një mashkull në korridor tha “e kanë vranë”. Pastaj Fahredin Gashi dhe Nazim Bllaca u larguan duke vrapuar dhe u nisën këmbë drejt fshatit Davidovc. Me të dalë nga dera kryesore; u kthyen në të djathtë dhe vrapuan 200-250 metra larg shtëpisë. Ata nuk kanë shtënë derisa po largoheshin. Pushuan aty dhe të nesërmen shkuan në Kleçkë. Ai deklaroi se

“pas kësaj, pasi u larguam nga ky vend, nuk kemi shkuar në Kleçkë, por në Davidovc dhe ishte akoma rrezik se serbët po tërhiqeshin. Dhe nuk ishte e sigurtë të shkonim në Kleçkë”.

59. Nazim Bllaca tha se ishte idea e Faruk Gashit që të shkonin në Davidovc, në drejtim të Godencit. Ata fjetën në shtëpinë e Sadik Abazit në Davidovc. Të nesërmen, shkuan në Kleçkë. Në atë kohë kishte lëvizje, tërheqja e forcave serbe nga Prizreni dhe Suhareka dhe zona që kaluan ishte e minuar.

60. Pasi që u larguan, ai e pyeti Fahredin Gashin për vrasjen “pse nuk më tregove që erdhën këtu për të vrarë njeriun?” Fahredin Gashi u përgjigj “nuk di çfarë të të them. U frikësova se nuk do të hysh brenda për t’a kryer këtë, për të qenë i pranishëm në vrasje”. Gashi tha “mos u merakos, e kemi mjekun” (nofka e Fatmir Xhelilit). Fahredin Gashi i tha Dëshmitarit Bllaca se Sali Gashi dinte diçka dhe se ishte bashkëpunëtor dhe se për shkak të kësaj, ata e kanë mbrojtjen e instancave më të larta.

IV.B. Besueshmëria e dëshmitarit bashkëpunues Nazim Bllaca

61. Dëshmia e dhënë nga Nazim Bllaca në gjykatë është prova kyqe në këtë lëndë. Si e tillë, çështja kryesore për t’u ngritur është besueshmëria e këtij Dëshmitari dhe saktësia e rrëfimit të tij. Nazim Bllaca ka dhënë deklaratat të shumta para se të japë dëshmi në gjykatë. Trupi Gjykoes shqyrtoi të gjitha këto deklaratat dhe ballafaqoi dëshminë e tij në gjykatë me deklaratat e dhëna më parë si dhe me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë. Trupi Gjykoes ka përcaktuar se rrëfimi i Nazim Bllacës i prezantuar këtu për vrasje është i qartë, preciz dhe i saktë dhe se dëshmitari është i besueshëm.

62. Edhe pse dëshmitari bashkëpunues ka karakter pompoz dhe dyshohet të ketë kryer vepra penale të neveritshme, Trupi Gjykoes e konsideron atë të jetë i besueshëm sa i përket deklaratave që akuzojnë të pandehurin Fahredin Gashi. Arsyeja më bindëse është se Nazim Bllaca akuzon veten e tij në mënyrë të rëndë duke bërë që të përballlet me pasoja dramatike personale sa i përket jetës dhe dënimit të rëndë. Ai ishte i gatshëm të duronte të gjitha kufizimet e lirisë dhe izolimit nga shoqëria dhe t’i nënshtrohej persekutimit nga qarqet me ndikim dhe drejtësisë. Rrëfimet e para janë bërë pa ndonjë premtim për imunitet nga ana e prokurorisë. Në fakt, Nazim Bllaca është akuzuar dhe ka marrë statusin e dëshmitarit bashkëpunues më vonë.

63. Nuk ka ndonjë indikacion se vetë-onkriminimet janë rezultat i fanatizmit, dëshirës patologjike për njohje apo ndonjë mani tjetër. Duket bindëse që dëshmitari bashkëpunues shpalosi krimet haptazi duke menduar se ikja e tij në publik do ta mbronte nga aktet e haktmarrjes nga SHIK-u dhe se vendimi i tij për të bërë pretendimet publike ishte shkaktuar nga brejtja e ndërgjegjës, pendimi dhe për kompensim.

64. Duke pasur parasysh se Nazim Bllaca ishte i përfshirë në vepra të rënda krimi, është e mundshme që mbrojtja të pretendojë se ai mbase është përpjekur të shfrytëzojë dijeninë e tij për kryerjen e veprave penale nga ana e Fahredin Gashit për t’u pasuruar nëpërmjet SMS, letrave apo telefonit.

65. Sidoqoftë, kjo nuk sjellë dyshim mbi vërtetësinë e deklaratave të Dëshmitarit Bllaca që inkriminon veten dhe të pandehurin. Përvoja e jetës na mëson se qeniet njerëzore nuk janë krejtësisht të liga apo të mira. Trupi Gjykoes është i bindur se Fahredin Gashi ka kryer veprën penale, pra që deklaratat e Dëshmitarit është e besueshme.

Versioni i Nazim Bllacës për vrasjen e Sali Gashit

66. Mbrojtja fuqishëm kundërshton kredibilitetin e Dëshmitarit Bllaca. Në fakt, Trupi Gjykues ka vënë re mospërputhjet në mes të deklaratave të dhëna në gjykatë dhe atyre të dhëna në një fazë të mëhershme të procedurës dhe si kundërshtime të tjera me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë në disa aspekte.

67. Nazim Bllaca deklaroi se ka mund të ketë qenë rreth orës 21.30 kur ai dhe Fahredin Gashi arritën në fshatin Varigovc në natën kritike. Ai është ballafaquar me deklaratën e tij të mëparshme, atë të datës 30 nëntor 2009, me ç'rast ka thënë se janë nisur nga Pjetershtica për në Varigovc në 21.00, dhe një herë tjetër ai ka përmendur orën 21.30. ai poashtu është pyetur lidhur me kohën e saktë të nisjes. Në gjykatë, Nazim Bllaca pranoi se "nuk mund t'a them saktë me minuta, ishte ora 21:35-21:40 kur kemi kryer krimin ..." koha e kryerjes së veprës penale është e rëndësishme për të përcaktuar rrethanat e veprës penale. Trupi Gjykues beson se papërputhshmëri sqarohet lehtë me faktin se ngjarja ka ndodhur pothuajse 12 vite më parë. Dëshmitari në gjykatë e pranoi se nuk i kujtohet koha e saktë e kryerjes së krimit. Sidoqoftë, Trupi Gjykues vë re se dëshmitari është konsistent se koha e përafërt ishte 21.00 - 21.40. Përpos kësaj, që nga viti 2007, Nazim Bllaca është marrë gjatë në pyetje lidhur me këtë krim si dhe me pretendime të tjera, dhe Trupi Gjykues është i mendimit se pavarësisht nga informatat e sakta që jep lidhur me vrasjen, atij mund t'i mos kujtohen me saktësi disa detale të ngjarjes apo mund t'i ketë ngatërruar.

68. Siç u tha më parë, Trupi Gjykues beson se dëshmia e Nazim Bllacës për krimin na aktakuzë është e besueshme. Atij i është kujtuar çdo hap i ndërmarrë duke u nisur që nga përgatitja për udhëtimin për në Varigovc e deri te largimi nga lokacioni i vrasjes. Ai poshtu sjell edhe detale lidhur me vrasjen dhe rrethanat. Ai jep detale jo vetëm për përshkrimin e shtëpisë por edhe të dhomës ku po qëndronte Sali Gashi. Të afërmit e Sali Gashit që ishin dëshmitarë të vrasjes konfirmuan versionin e Nazim Bllacës.

69. Trupi Gjykues beson se papërputhshmëritë nuk kanë të bëjnë me elemente fundamentale që mund të ndryshojnë versionin e përgjithshëm të vrasjes apo përgjegjësinë e Fahredin Gashit. Ata janë papërputhshmëri të vogla dhe nuk mund të zvogëlojnë saktësinë e deklaratës së dëshmitarit. Në gjykatë Nazim Bllaca ka pasur mundësinë të sqarojë këto papërputhshmëri me deklaratat e mëparshme dhe i qartësoi.

70. Trupi Gjykues ka parasysh rrethanat e veçanta të ngjarjes së datës 15 qershor 1999: dëshmitari bashkëpunues ka hyrë në një shtëpi të panjohur; nuk ka pasur dijeni se çfra po ndodhte; të afërmit e viktimës ishin të pranishëm dhe po silleshin në mënyrë të çrregullt; kishte fare pak dritë në shtëpi. Për më tepër, Trupi Gjykues është i mendimit se është e natyrshme që njeriu të devijojë nga deklaratat e tij të mëparshme, sidomos duke pasur parasysh kohën që ka kaluar që nga kryerja e veprës penale. Është poashtu e mundshme se versioni i tij është kontaminuar nga diskutimi me të tjerë. Nazim Bllaca është intervistuar disa herë, dhe deklaratat e tij janë konsistente.

71. Vërtetësia e deklaratave të mëparshme të Nazim Bllacës nuk zvogëlohet nga fakti se i ka dhënë pjesërisht para policisë dhe prokurorisë si i dyshuar dhe dëshmitar. Shihet se së pari raportoi në polici në korrik 2007. Ai ka dhënë disa deklarata gjatë procedurës paraprake si dëshmitar, pastaj si i dyshuar dhe më vonë si dëshmitar bashkëpunues. Nazim Bllaca është shpallur dëshmitar bashkëpunues me anë të vendimit të gjykatës në shtator 2010.

72. Gjykata e Qarkut beson se ndryshimi i statusit nga dëshmitar në të dyshuar apo pandehur nuk ka ndikim vendimtar në vlerën e provës edhe pse nuk sjellë qartësi dhe mund të sjellë vështirësi në vlerësimin e kredibilitetit të dëshmitarit. Të gjitha intervistimet kanë qenë në pajtim me ligjin e procedurës. Për intervistim në cilësinë e të dyshuarit, Nazim Bllaca është udhëzuar mbi të drejtën e tij për të qëndruar në heshtje. Por, ai ka dhënë deklaratën e tij të parë duke akuzuar veten dhe Fahredin Gashin. Për intervistim në cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues, ai është udhëzuar të tregojë të vërtetën dhe se ka të drejtë të mos inkriminojë veten. Ai ka dhënë këto deklarata duke konfirmuar të njëjtat të dhëna si i dyshuar. Në fund, baza e vlerësimit të gjykatës është deklarata e Nazim Bllacës si dëshmitar bashkëpunues në shqyrtim kryesor. Vlera e provës theksohet nga konsistenca e versionit të tij të ngjarjes.

73. Kredibiliteti i Nazim Bllacës nuk zvogëlohet me faktin se përfundimisht procedura penale kundër Fahredin Gashit është ndërprerë sa i përket vrasjes së Adem Rusinovicit (Adem Lahut). Është e vërtetë se pas deklaratës së Nazim Bllacës mbi përfshirjen e mundshme në vrasje të Fahredin Gashit më 3 korrik 2007, ka nisur hetimi. Procedura është mbyllur për shkak të mungesës së provave. Përpos kësaj, prokuroria në mënyrë bindëse vë re se Dëshmitari Bllaca nuk ka akuzuar drejtpërdrejtë Fahredin Gashin, por vetëm ka raportuar pjesëmarrjen e tij të mundshme.

74. Faktet dhe rrethanat lidhur me daljen në publik të dëshmitarit bashkëpunues nuk mund të sjellin dyshime mbi vlerën e provave. Është e kundërta, ato e mbështetin. Kryesisht, deklaratat e dëshmitarëve Gani Geci dhe Adem Salihaj demonstrojnë besueshmërinë e versionit të Nazim Bllacës dhe e përjashtojnë mundësinë se ka vepruar me dëshirë për njohje, përfitim financiar apo motiv tjetër të pandershëm.

75. Duket qartë se inçizimi i veprave që pretendohen të jenë kryer nga Nazim Bllaca, Fahredin Gashi dhe të tjerë anëtarë të pretenduar të SHIK-ut është iniciuar nga Gani Geci dhe Adem Salihaj pasi që Nazim Bllaca kishte kontaktuar Gecin. Nazim Bllaca përmendi edhe vrasjen në tentativë të Adem Salihajt më 2000. Në shqyrtimin kryesor, Adem Salihaj shprehu çudi për saktësinë e versionit të Bllacës për vrasjen në tentativë të dëshmitarit, p.sh. vendndodhjen e shtëpisës së Salihajt. Konfirmohet vërtetësia deklaratës së Bllacës sa i përket vrasjes që trajton procedura aktuale. Vetëm një pjesëmarrës apo dëshmitar i vrasjes në tentativë do të mund të jepte një përshkrim kaq të saktë.

76. Sipas deklaratave të tyre, Gani Geci dhe Adem Salihaj kanë qenë ata të cilët e kanë bindur Nazim Bllacën t'i xhiroj akuzat e tij. Të dytë kanë deklaruar se xhirimi është i bazuar vetëm në zbulimet e Nazim Bllacës, i cili ka folur pa ndërprerje. Sa i përket dorës me një copë letre që shihet në xhirim, Gani Geci e spjegon se ia ka shkruar Nazim Bllacës pyetjet siç është: "Na trego si i ka dhënë Azem Sylaj urdhrin për ta vrarë dajën/axhën e tij."

77. Adem Salihajt u kujtua se si pastaj Nazim Bllaca sqaroi se si ia doli të jetë në një situatë ballafaqese me struktura të SHIK-ut dhe përpjekjet e SHIK-ut dhe anëtarëve të organizuar të krimit për t'a vrarë. Që të dy dëshmitarët deklaruan se Nazim Bllaca tregoi se ndjen pendesë për të gjitha veprimet e tij dhe se xhirimi ishte një mënyrë për të kontribuar për pendim. Gani Geci dëshmoi se Nazim Bllaca kurrë nuk ka kërkuar të holla. Ishte idea e Nazim Bllacës të sjellë një kopje të kësaj DVD të afërmeve të viktimave. Gani Geci dhe Adem Salihaj kanë bërë kopje të DVD-së së prezantuar gjatë dy konferencave për shtyp: asaj që mbahej nga Gani Geci dhe Adem Salihaj në korridorin e Parlamentit të Kosovës, tjetrën nga Nazim Bllaca në shesh të Prishtinës.

78. Fakti që Nazim Bllaca pretendoj të ketë pasur idenë për xhirim pas një takimi të mbajtur me prokurorin Theo Jacobs në maj të vitit 2009, nuk sjellë dyshime thelbësore në korrektësinë e deklaratave të Bllacës dhe konfirmi i tyre nga dëshmitarët Geci dhe Salihaj. Geci dhe Salihaj theksuan se Nazim Bllaca u pajtua të bënte xhirimin.

79. Fakti që publikimi i xhirit nuk ka pasur motive bazë është siguruar nga fakti që Nazim Bllaca ka qenë i gatshëm të i nënshtrohet ndjekjes penale dhe privimit nga liria. Pas xhirit ai është marrë në pyetje nga prokurori dhe është informuar për akuzat kundër tij, kryesisht lidhur me krimet që përmenden në DVD-në e tij.

80. Dyshimet në korrektësinë e deklaratave të Nazim Bllacës që janë ngritur nga mbrojtja nuk kanë ndikim në besimin e Trupit Gjykses se Fahredin Gashi ka qenë kryerës i vrasjes së Sali Gashit. Nazim Bllaca i ka dërguar një letër Afrim Gashit, djalit të viktimës, duke shpjeguar se aty ka përmendur tre persona të përfshirë në krim sepse në atë kohë nuk ka dashur t'a zbuloj përfshirjen e tij.

81. Nuk ka dëshmi se akuzat e Nazim Bllacës kanë ardhur nga urrejtja kundër ish shokut të tij Fahredin Gashi apo nga kopracia. Është e vërtetë se marrëdhënia e tyre e mirë personale dhe marrëdhënia e punës ka filluar të përkeqësohet më 2006 për shkak të një mosmarrëveshje lidhur me blerjen e një patundshmërie. Takime të shumta janë organizuar nga të afërmit e familjës dhe nga të njohurit e tyre, duke u përpjekur ta zgjedhin çështjen e parave, *inter alia* një takim është mbajtur në shtëpinë e Idriz Bllacës në verën e 2007 duke përfshirë Fahredin Gashin, Reshat Gashin, Shpresim Ukën, Driton Hajdarin, Sherif Halilun, Asllan dhe Azem Bllacën.

82. Dëshmitarët e pyetur, kryesisht Reshat Gashi, i akuzuari Nazim Bllaca duke i kërkuar Fahredin Gashit të holla me ngulm. Ata që ishin në anën e Nazim Bllacës fuqimisht e kundërshtojnë këtë, duke thënë që Fahredin Gashi i ka pasur borxh Nazim Bllacës dhe i ka bërë atij presion. Për shkak të faktit se dëshmitarët Shaban Sylja dhe Shpresim Uka janë të akuzuara me disa vepra penale në bashkë-kryerje me Fahredin Gashin, duke u bazuar në dëshminë e Nazim Bllacës, dëshmitë e tyre nuk mund të vënë në dyshim vërtetësinë e deklaratave të dhëna nga dëshmitari bashkëpunues. Në ndërkohë kredibiliteti i tij është përkrahur nga fakti se "rastit Bllaca dy" është iniciuar.

Përdorimi i dëshmisë të dhënë nga dëshmitari bashkëpunues si bazë e vetme e aktgjykimit dënues dhe provave vërtetuese.

83. Trupi Gjykses thekson se provat kyqe në këtë rast janë deklarata e dëshmitarit bashkëpunues Nazim Bllaca. Duke pasur parasysh të statusit se dëshmitari bashkëpunues, përkufizimi nën Nenin 157 para 4 e KPPK zbatohet. Aktgjykimi dënues nuk mund të denohet vetëm në bazë të deklaratave të dëshmitarit bashkëpunues.

84. Siç është përmendur më parë, Trupi Gjykses gjenë se versioni i Nazim Bllacës për vrasjen e Sali Gashit më 15 qershor 1999 është i qartë konsistentë. Është konfirmua nga deklaratat e anëtarëve të familjës që ishin dëshmitarë të vrasjes.

85. Të afërmit e Sali Gashit kanë dhënë disa detale të dukjes fizike së dy personave. Të gjithë kanë deklaruar se njëri ishte i gjatë dhe tjetri i shkurtër. Hyrije Gashi në gjykatë është pyetur nëse mendon që Fahredin Gashi ka mundur të jetë njëri prej personave që kanë hyrë në shtëpi. Ajo sinjerisht tha "Nuk mund të them sepse mbanin maska" dhe personi ishte pak më i dobët. Sipas Afrim Gashit personi i shkurtër ecte me këmbë të afuara me njëra-tjetrën. Ai

tregoi me gisht Fahredin Gashin pasi kishte dukje të ngjashme me personin që kishte kryer vrasjen e babait të tij. Ky përshkrim korresponon me dukjen e të pandehurit dhe të dëshmitarit bashkëpunues edhe pse kanë shtuar në peshë.

86. Anëtarët e familjës poashtu kanë konfirmuar versionin e Nazim Bllacës sa i përket modaliteteve të hyrjes në shtëpi, rrethanave të ngjarjes, territ në dhoma për shkak të mungesës së rrymës elektrike, qasjes së kryerësve, sjellja e tyre, të qenurit të armatosur, rrjedha e krimit, largimi i tyre nga shtëpia me nxitim. Trupi Gjykues gjen se është vertetuar se dijenia e të afërmëve të viktimës mbi rrethanat nuk është se vjen nga kontakti në mes të Nazim Bllacës dhe familjes së Sali Gashit. Pavarësisht nga disa papërputhshmëri në detale, deklaratat e të afërmeve të viktimës kanë dhënë një raport ilustrues lidhur me ngjarjen e asaj nate, e cila konfirmon versionin e dëshmitarit bashkëpunues.

IV. C. Alibia e paraqitur nga mbrojtja e Fahredin Gashit

87. Mbrojtja pretendon se Fahredin Gashi nuk ka mundur të kryejë vrasjen e Sali Gashit në natën e vonshme të 15 qershorit 1999, sepse në këtë ditë Fahredin Gashi e ka festuar fundin e konfliktin së bashku me Hysni Arifin, Jakup Ismailin, Reshat Gashin, Musa Baftiun, Ajvaz Karpuzin dhe Naser Bytyqin në shtëpinë e Hysni Arifit në Shtime. Për këtë qëllim mbrojtja i referohet personave të përmendur të quajtur si dëshmitarë dhe një fotografie të të gjithë personave të përmendur që pretendohet se është bërë në atë datë. Edhe pse të gjithë dëshmitarët kanë konfirmuar se festa është mbajtur dhe e konfirmojnë datën e mbledhjes (vetëm Naser Bytyqi nuk ishte i sigurt lidhur me datën), Trupi Gjykues nuk mund të thotë se kjo ngjarje përbën alibi për Fahredin Gashin.

88. Një prej brengave kryesore qendron në faktin se pandehuri nuk e përmend këtë ngjarje në fazën paraprake dhe ia ka paraqitur fotografinë Prokurorit Publik më vonë. Spjegim i tij se nuk i kanë kërkuar të paraqet alibi nuk është bindëse. Çdo person i akuzuar me vepër penale të rëndë do t'i ishte referuar mjeteve kaq të rëndësishme të mbrojtjes që mbase do të mund të parandalonin barrën e procedurës penale. Trupi Gjykues u falë besimin edhe deklaratave të dhëna nga dëshmitarët e përmendur. Ata janë intervistuar pas më shumë se 12 vjetëve pas ngjarjes së pretenduar që ngjallë dyshime në kujtesën e tyre se a është data e festimit korrekte. Është habi se si të gjithë kanë kujtimin e njeëtë të asaj dite. Ka gjasa që kujtesa e tyre është njollosur dhe ndryshuar nga diskutimet që kanë pasur pas marrjes në pyetje të Jakup Ismailit nga ana e Prokurorit. Ngrit shqetësimin se ishte Reshat Gashi i cili shënoi datën 15 qershor në fotografi "sepse ishte datë e rëndësishme". Disa nga dëshmitarët janë të afërt me Fahredin Gashin, ne veçanti Reshat Gashi i cili është i afërm dhe ka qenë i përfshirë si ndërmjetësues në bisedimet për çështjen e parave në mes të Nazim Bllacës dhe Fahredin Gashit. Reshat Gashi pranoi se i kishte kërkuar mbrojtja ta kërkonte fotografinë.

89. Por, edhe nëse mbledhja është mbajtur më 15 qershor, kjo nuk vërteton që Fahredin Gashi nuk ishte në vendin e krimit siç e përshkruan dëshmitari bashkëpunues. Ka paqartësi se në sa ora e kanë lënë shtëpinë e Hysni Arifit pjesëmarrësit në festë, dhe sa kohë nevojitet që të shkohet nga Shtimja deri në Varigovc.

90. Lidhur me kohën e shkuarjes nga shtëpia e Hysni Arifit, Reshat Gashi ka dëshmuar në gjykatë se "mund të ketë qenë ora tetë e mbrëmjes kur kemi arritur në shtëpinë e kolegut Hysni Arifi, nuk mund të them sigurt". Ai poashtu deklaroi se kur kanë arritur në shtëpinë e Naser Bytyqit që është 20 minuta larg nga shtëpia e Hysni Arifit, ishin të ndezur dy qirinjë. Hysni Arifi ka thënë se kur kanë arritur në shtëpinë e Naser Bytyqit pas 20 minutave vozitje,

aty ishin të ndezur qirinjtë; në deklaratën e tij para Prokurorit ka thënë "po errësohej". Jakup Ismajlit i kujtohet vetëm që festa është mbajtur pasdite dhe ata kanë qenë aty "për një kohë". Naser Bytyqit i kujtohet vetëm që festa është mbajtur pasdite dhe ata kanë ardhur "në shtëpinë time [në Qylagë] para mbrëmjes sepse shtalla ishte e djegur"; kur janë nisur nga Qylaga, duke shkuar në Pjetershtice, "ishte vonë në mbrëmje." Sa i përket Hysni Arifit, ai ka thënë se festa ndoshta ka zgjatur deri në ora 3 apo 4 dhe kur ai dhe Jakup Ismaili kanë arritur në fshatin Lloshkobare, sa e mbanë në mend, kishte akoma dritë të ditës.

91. Nuk ka bazë për të supozuar se Fahredin Gashi dhe Nazim Bllaca nuk kanë mundur të arrijnë në vendin e krimit para se të ndodhte vrasja. Ka paqartësi se cilën rrugë kanë marrë, si kanë lëvizur përpara, sa ka qenë distanca e madhe, kur ka ndodhur vrasja.

92. Dëshmitarit Bllaca nuk i kujtohet se nga cila rrugë saktësisht kanë shkuar. Prokurorit iu është dhënë detyra për të bërë një vlerësim të kohës dhe distancës në mes të fshatrave Pjetershtice dhe Varigovc. Dëshmitari George Pleasant, zyrtar policor i EULEX-it ka bërë kalkulimin. Ai deklaroi në gjykatë se për "për shkak të rritjes së drunjëve, Bllaca nuk ishte në gjendje të tregonte rrugën e njejtë që e ka bërë atë natë". Raporti i lëshuar nga policia e datës 26 shtator 2011 nxjerr si përfundim se distanca mes Pjetershticës dhe Zbrocit është rreth 3 kilometra dhe është përshkuar për rreth 55 minuta; distanca mes Zbrocit dhe Varigovcit është rreth 3 kilometra dhe është përshkuar për rreth 45 minuta (gjithsejt 1 orë e 40 minuta). Në raportin e datës 27 korrik 2011, distanca 7.9 km nga Shtimja deri në Pjetershticë mund të kalohet me veturë për 12 minuta. Afrim Gashi dëshmon se për të ecur nga Varigovci deri në Pjetershticë gjatë konfliktit ka marrë më së shumti 1 orë, por është vetëm vlerësim i përafërt pasi aanjëherë nuk e ka matur kohën dhe se natën merr më shumë kohë.

93. Për shkak të dyshimit të arsyeshëm në festën e përmendur në ditën e vrasjes si dhe deklaratat e dyshimta të disa dëshmitarëve, Trupi Gjykes përjashton mundësinë që i pandehuri të ketë pasur alibi. Mbrojtja gabimisht argumenton se ekziston shkelja e parimit in dubio pro reo. Ky parim mund të aplikohet vetëm në rast të ekzistimit të dyshimit të arsyeshëm, i cili nuk mund të përjashtohet pas vlerësimit të tërësishëm të provave, gjë e cila nuk vlen këtu.

IV.D. Kualifikimi ligjor i vrasjes së Sali Gashit

94. Vrasja e Sali Gashit, kryer në bashkë-kryerje me Fahredin Gashin më 15 qershor 1999 duhet të kualifikohet si krim lufte kundër popullsisë civile sipas nenit 142, KP SFRJ. Ky nen lexon: "kushdo që në shkelje të ligjit ndërkombëtar ne fuqi në kohë të luftës, konfliktit të armatosur apo okupimit urdhron që popullata civile t'i nënshtrohet vrasjeve, [...], apo që kryen njërin nga aktet e mëparshme dënohet me burgim prej jo më pak se pesë vjet ose me dënim me vdekje." Aktualisht penalizohet me nenet 23 dhe 120, KPK.

95. Lidhur me nenin 142, KP RSFJ, dispozitat relevante të Konventave të Gjenevës dhe jurisprudenca e përcaktuar mirë e Tribunalit Ndërkombëtar për Krime dhe gjykatat e Kosovës⁸³ elementet e krimeve si në vijim duhen përmbushur që sjellja kriminale të definohet si krim lufte kundër popullatës civile:

⁸³ shih *inter alia* neni 3 i përbashkët me katër konventat e Gjenevës 12 gusht 1949, Protokolli Shtesë II to the Konventave të Gjenevës 12 gusht 1949 lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura jo-ndërkombëtare 8 qershor 1977; Lënda nr. IT-04-84-T, Prokurori v. Ramush Haradinaj et al., aktgjykimi I shkallës së parë, 3 prill 2008: "36. Pas përcaktimit të juridiksionit, duhen plotësuar tre kushte të përgjithshme që të zbatohet neni 3 i ligjit: e para, duhet të ketë konflikt të armatosur; e dyta, duhet të ketë neksus në mes të

- Ekzistimi i konfliktit tz brendshëm të armatosur;
- Pjesëmarrja e të akuzuarit në konflikt të armatosur;
- Neksus në mes të krimit që pretendohet dhe konfliktit të armatosur;
- Statusi civil i viktimës (person i mbrojtur);
- Pjesëmarrja e të akuzuarit në vepër penale dhe
- Se sjellja penale përbën shkelje të ligjit vendor dhe atij ndërkombëtar në fuai në kohën e sjelljes (test dualizli).

Ekzistenca e konfliktit të brendshëm të armatosur në kohën e sjelljes kriminale

96. Jurisprudenca ndërkombëtare definojnë konfliktin e brendshëm të armatosur si “zgjedhja apo përdorimi i forcës së armatosur apo dhunë të zgjatur të armatosur në mes të autoriteteve qeveritare dhe grupe të organizuara të armatosura brenda një shteti.”⁸⁴ Sipas këtij testi, për të përcaktuar ekzistimin e konfliktit të armatosur me karakter të brendshëm, Trupi Gjykyes duhet të vlerësojë dy kritere: (i) intensitetin e konfliktit dhe (ii) organizimin e palëve.”⁸⁵

97. Kushtet thelbësore për vërtetimin e ekzistimit të konfliktit të armatosur janë:

- a) që dhuna e armatosur e zgjatur ndodhë në mes të autoriteteve qeveritare dhe grupeve të organizuara të armatosura apo në mes të grupeve të tilla brenda një shteti;
- b) që këto grupe, nën komandë përgjegjëse ushtrojnë kontroll të tillë mbi një pjesë të territorit të shtetit për t’i mundësuar që të ndërmarrin operacione ushtarake të qëndrueshme dhe në bashkë-veprim dhe për të zbatuar Protokollin II Konventave të Gjenevës gusht 1949 dhe
- c) që armiqësitë tejkalojnë nivelin që mund të karakterizohen si thjeshtë trazira të brendshme, tensione, akte të izoluara dhe sporadike dhune dhe vepra të tjera të natyrës së ngjashme.⁸⁶

98. Trupi Gjykyes është i mendimit se në Kosovë ka ekzistuar konflikt i armatosur në mes të focave të armatosura të sigurimit të Republikës së Serbisë dhe të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe UÇK-së si palë ndërluftuese në kohën në fjalë. Që të dy palët kishin forca të armatosura nën komandë përgjegjëse, dhe ushtronin kontroll mbi ca pjesë të territorit të Kosovës duke u mundësuar që të kryejnë operacione të qëndrueshme dhe në bashkë-veprim nga viti 1998 deri të paktën më 15 qershor 1999. Për këtë qëllim, Gjykata e Qarkut i referohet dokumenteve zyrtare të organizatave ndërkombëtare, *inter alia*: Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSOKB), Rezolta 1199 (1998) nga 23 shtatori 1998, KSOKB Rezoluta 1244 (1999) nga 10 qershor 1999,⁸⁷ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/1, datuar 25 korrik 1999, Raporti për Prokurorin e TNKL.⁸⁸

veprës që pretendohet dhe konfliktit të armatosur; dhe e treta, për akuzat e bazuara në Nenin e Përbashkët 3, vitkima nuk duhet të marrë pjesë aktive në armiqësitë në kohën e krimit të pretenduar.”; Lënda Gjykata e Qarkut në Prishtinë, P Nr. 215/04, Prokurori v. Rrustem Dema et al., aktgjykimi i shkallës së parë, 12 maj 2005, faqe 47

⁸⁴ Lënda IT-94-1-AR72, Prokurori v. Tadic, Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ankesë ndaj Juridiksionit, 2 tetor 1995, para. 70.

⁸⁵ Lënda IT-03-66-T, Prokurori v. Fatmir Limaj et al., aktgjykimi i shkallës së parë, 30 nëntor 2005, para 84; shih edhe IT-02-60-T, Prokurori v. Vidoje Blagojevic et al, aktgjykimi i shkallës së parë, 17 janar 2005, para 536

⁸⁶ Shih Protokollin Shtesë II Konventave të Gjenevës 12 gusht 1949; Lënda No. ICTR-96-4-T Prokurori v. Akeyesu, aktgjykimi i shkallës së parë, 2 shtator 1998, para 620 dhe 625; shih edhe Lënda Gjykata e Qarkut në Prishtinë/Priština, P no. 425/2001, Prokurori v. Latif Gashi et al., 16 korrik 2003, faqe 10

⁸⁷ Shih edhe Rezolutën e KS të OKB-së 1160 (1998) datuar 31 mars 1998

⁸⁸ Raporti mbi Shkelje të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar në Kosovë më 1998, shkurt 1999, faqe 15 – 19.

99. Trupi Gjykses mbështetet edhe në jurisprudencën ndërkombëtare.⁸⁹ Në lëndën e Ramush Haradinaj et al., Trupi Gjykses gjeti se “konflikti i armatosur ka ekzistuar në Kosovë nga data 22 prill 1998 e tutje. Trupi Gjykses ka pranuar një sasi voluminoze të provave lidhur me konfliktin e armatosur nga maji deri në shtator 1998. UÇK-ja vazhdoi të zhvillojë organizimin e saj përgjatë periudhës për të cilën bën fjalë aktakuza. Operacionet luftuese vazhduan dhe arritën nivele të larta të intensitetit gjatë sulmeve të mëdha të serbëve në rajonin e Dukagjinit në majin e vonshëm, fillimi deri në mes të gushtit dhe shtatori i hershëm 1998.”⁹⁰

100. Gjykata është pajisur me ca elemente lidhur me organizimin dhe komandimin e UÇK-së nga disa dëshmitarë. Dëshmitari Nazim Bllaca deklaroi se është rivendosur në batalion më 1 mars 1999 nën komandimin e Ramiz Queiri për të vizituar pikat në fshatrat Zborc dhe Blinaje, zëvendës komandanti i batalionit ishte Elez Durmishi. Sipas dëshmitarit Ramiz Luani Qeriqi, Brigada 121 ishte e ndarë në katër batalione dhe brigada udhëhiqej nga Komandanti Fatmir Limaj. Ramiz Qeriqi ishte Komandanti i Batalionit 2, Ismet Jashari-Kumanova ishte Komandanti i Batalionit 3, Skender Hoti ishte Komandant i Batalionit 4 dhe Komandanti i Batalionit 1 ndryshonte gjatë gjithë kohës. Syljeman Qeriqi dhe pastaj Elez Durmishi ishin zëvendësit e Ramiz Qeriqit.

101. Konflikti në Kosovë ishte çështje teme për raporte të zgjatura dhe të detalizuara të organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-së. Në mes tjerash, raportet e OSBE-KVM Report dhe Organizata për të Drejtat e Njeriut ofrojnë informata të vlefshme mbi armiqësitë e vazhdueshme në Kosovë drejt qershorit 1999, në veçanti në rajonin e Lipjanit ku ndodhi vrasja e Sali Gashit.

102. OSBE-ja raportoi mbi tiparet vijuese kryesore të armiqësive në rajonin e Lipjanit: sjelljen e tankeve, veturave të blinduara dhe armëve në fabrikën e letrës në Lipjandhe ndërtesa të shkollave të mesme nga forcat serbe në natën e 24 - 25 mars 1999 në Lipjan dhe në fshatra me shqiptarë në Kosovë në atë rajon; zhvendosja e detyruar e personave; vjedhja dhe djegia e shtëpive, rrahja e shqiptarëve të Kosovës, sulmi, (përfshirë bombardimin) e fshatrave; vrasja e shqiptarëve të Kosovës më 15 and 16 prill 1999 në fshatin e Slovinjes; arrestimin dhe paraburgimin e paligjshëm në burgun në Lipjan.⁹¹ Sipas raportit të ODNJ-së, “edhe pse komuna e Lipjanit nuk ka qenë qendër e aktiviteteve të UÇK-së, forcat e sigurisë serbe janë përqëndruar aty në periudhën në mes të marsit dhe qershorit 1999. Dëshmia e më shumë se tridhjetë dëshmitarëve nga rajoni, intervistuar nga ODNJ-ja tregon për një model sulmi ndaj shumë fshatrave përderisa dis fshatra të tjera jan kursyer ngë sulmi i drejtpërdrejtë.”⁹² ODNJ-ja përmendë edhe keqtrajtimet pas datës 12 qershor 1999, p.sh. sulmet ndaj minoriteteve, dhuna ndaj shqiptarëve.

⁸⁹ Lënda IT-03-66-T, Prokurori v. Fatmir Limaj et al., aktgjykimi i shkallës së parë, 30 nëntor 2005, para 83 dhe fol., dhe para. 171-173: “Dhoma është e mendimit se para datës maj 1998 ka ekzistuar konflikt i armatosur në Kosovë në mes të forcave serbe dhe UÇKS-së [Ushtria Çlirimtare e Kosovës].[...].”; shih *inter alia* Lënda Gjykata e Qarkut në Prizren, P nr. 85/2005, Prokurori v. Selim Krasniqi et al., 10 gusht 2006, faqe 24 dhe fol.; Lënda Nr. IT-04-84-T, Ramush Haradinaj et al., aktgjykimi i shkallës së parë, 3 prill 2008, para. 38, 39, 40, 42, 45, 53, 55, 56 deri në para. 89 të aktgjykimit për organizimin e UÇK-së si forca të armatosura që veprojnë në territorin e Kosovës; intensiteti i konfliktit sipas para. 90

⁹⁰ Lënda IT-04-84-T, Prokurori v. Ramush Haradinaj et al., aktgjykimi i shkallës së parë, 3 prill 2008, para 100; shih *inter alia* Lënda Gjykata e Qarkut në Prizren, P nr. 85/2005, Prokurori v. Selim Krasniqi et al., 10 gusht 2006, faqe 24 dhe fol.

⁹¹ OSBE-KVM Kosovë “si është parë, si është treguar” Pjesa 1 Përmbledhje ekzekutive, faqe 454.

⁹² Organizata për të Drejtat e Njeriut, Raporti ‘nën urdhra, krime lufte në Kosovë’, Pjesa II, faqe 261; shih edhe faqet 261-279

103. Dëshmitarët e ftuar kanë dhënë pak indikacione sa i përket situatës së armiqësive në këtë rajon. Afrim Gashi deklaroi se nuk ka pasur forca serbe në afërsi. Sa i përket Hyrije Gashit, kjo tha se ka qenë qetësi dhe se nuk ka pasur forca serbe përreth. Mirëpo, në fillim të luftës, ata u zhvendosën nga Ribari në Gllgovc dhe pastaj qëndruan në mal. Janë zënë nga serbët dhe qëndruan në Gordanc. Mirishahe Gashi deklaroi se nuk ka parë ushtarë, madje as para ngjarjes. Në anën tjetër, Shefikje Gashi konfirmoi në gjykatë deklaratën e saj të mëparshme se “unë vrapoja shpejt se serbët po vinin apo diçka e keqe i kishte ndodhur gruas së xhaxhasë” dhe se “më kujtohet se kam rënë të fle me rroba veshur sepse kishim frikë se do të vinin serbët”. Nazim Bilaca poashtu deklaroi se pas kryerjes së vrasjes, ai dhe Fahredin Gashi u nisën në drejtim të Godencit për të shkuar në Davidovc se “në atë kohë kishte lëvizje, tërheqja e forcave serbe nga Prizreni dhe Suhareka dhe zona që kaluan ishte e minuar.” Ai poashtu deklaroi se qeveria e përkohshme dhe disa ministri, përfshirë edhe Ministrinë e Mbrojtjes ishin akoma në malet Berisha mountains dhe akoma kishte forca serbe që nuk ishin larguar nga Kosova.

104. Trupi Gjykses kujton se ligjet apo zakonet e lufton mund të vihen në zbatim në një kohë dhe një vend ku nuk ndodhin luftime. Komuna në një rajon ku zhvillohet një konflikt i armatosur mund të konsiderohet vend i konfliktit të armatosur edhe nëse nuk ka armiqësi aktive në vetë komunën.⁹³

105. Trupi Gjykses gjen se rajoni i Lipjanit, respektivisht fshati Varigovc nuk iu nënshtrua luftimeve të rënda në mes në palve ndërluftuese në kohën në fjalë. Sidoqoftë, mungesa e luftimit aktual në rajonin në fjalë nuk e përjashton vetë ekzistimin e konfliktit të brendshëm të armatosur. Për më tepër, palët nuk e mohojnë ekzistimin e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë. Mbrojtja pretendon se konflikti i armatosur në Kosovë veç kishte përfunduar më 15 qershor 1999. Qëndrimi i mbrojtjes është se Rezoluta 1244 (1999) i dha fund konfliktit më 10 qershor 1999. Me këtë rezolutë, Këshilli i Sigurimit ka vendosur të sjellë prani të forcave ndërkombëtare civile dhe të sigurisë në territorin e Kosovës. Sidoqoftë, Trupi Gjykses gjen se konflikti nuk ka përfunduar me anë të rezolutës në fjalë.

106. Në fakt, ligji ndërkombëtar humanitar zbatohet nga inicimi i konflikteve të tilla të armatosura dhe shkon përtej ndërprerjes së armiqësive derisa të arrihet një përfundim i përgjithshëm i paqës apo siç është rasti me konfliktet e brendshme, arrihet një marrëveshje paqësore. Deri në atë çast, vazhdon të zbatohet ligji ndërkombëtar humanitar në gjithë territorin nën kontrollin e një pale pavarësisht se a ka luftime apo jo aty, në rastin e koflikteve të armatosura.⁹⁴ Ky qëndrim konfirmohet nga formulimi i përdorur në Konventat e Gjenevës dhe Protokollin Shtesë II. Jurisprudenca vendosi, “sa i përket kornizës së konflikteve ndërkombëtare të armatosura, secila nga katër konventat e Gjenevës përmban gjuhën sipas së cilës, zbatimi i tyre mund të zgjatet pas ndërprerjes së luftimeve.”⁹⁵

⁹³ Lënda IT-95-14-T, Prokuroriv. Tihomir Blaskic, aktgjykimi i shkallës së parë, 3 mars 2000, para. 64; shih Lënda Gjykata e Qarkut në Prizren, P. Nr. 44/2000, Prokurori v. Andjelko Kolasinac, aktgjykimi i shkallës së parë, 14 qershor 2001, faqe 6

⁹⁴ Shih lëndën IT-04-84-T, Prokurori v. Ramush Haradinaj et al., aktgjykimi i shkallës së parë, 3 prill 2008, para 100

⁹⁵ Lënda IT-94-1-AR72, Prokurori v. Dusko Tadic, vendimi ndaj kërkesës së mbrojtjes për ankesë në juridiksion, 2 tetor 1995, para 67, shih edhe para 69: “69. Korniza gjeografike dhe temporale për konflikte të brendshme të armatosura është ngjashmërisht e gjërë. Ky koncept reflektohet në faktin se përfituesit e nenit të përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës janë ato që nuk marrin pjesë aktive (apo që tanimë nuk marrin pjesë aktive) në armiqësi. Kjo tregon se rregullat në nenin 3 janë të zbatueshme edhe jashtë kontekstit të ngushtë gjeografik të vetë operacioneve ndërluftuese. Ngjashmërisht, gjuha e caktuar në Protokollin II të Konventave të

107. Trupi Gjykues vë re se në këtë Rezolutë 1244 (1999), Këshilli i Sigurimit “kërkon në veçanti që Republika Federative e Jugosllavisë menjëherë të vëjë një fund të verifikueshëm dhunës dhe regresionit në Kosova nga të gjitha forcat ushtarake, policore dhe paramilitare [...]”⁹⁶. Këshilli i Sigurimit kërkon që UÇK-ja dhe grupet e tjera ta armatosura të Kosovës “menjëherë të ndalojnë të gjitha veprimet e sulmit dhe t’u binden kërkesave për demilitarizim, theksuar nga shefi i pranisë së sigurisë ndërkombëtare në konsultim me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm.”⁹⁷

108. Një rregullore tjetër, ajo e UNMIK-ut nr. 1999/1, adoptuar më 25 korrik 1999 dhe e futur në fuqi më 10 qershor 1999, kërkon mbartjen e pranisë civile ndërkombëtare në Kosovë me të gjitha autoritetet legjislative dhe ekzekutive në Kosovë, përfshirë edhe administrimin e gjyqësisë. Marrëveshja Teknike Ushtarake në mes të Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë (KFOR) dhe qeverive të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë (njohur si Marrëveshja e Kumanovës) është nënshkruar më 9 qershor 1999. Është e qartë se kjo marrëveshje ka të bëjë me ndalimin e armiqësive të konfliktit ndërkombëtar të armatosur, siç edhe është nënshkruar nga forcat ndërkombëtare dhe qeveritë e RFJ-së dhe Serbisë. UÇK-ja nuk është nënshkruar i marrëveshjes. Për më tepër, në brifingun mëngjesor të NATO-s, datuar 17 qershor 1999,⁹⁸ përmendet tërheqja e forcave serbe si dhe situata humanitare. Sipas brifinut, forcat e NATO-s udhëzuan refugjatët se është “më e sigurtë të qëndrojnë aty ku janë derisa të mund të garantohet ambienti i sigurisë”. Përmenden edhe negociatat me UÇK-në mbi marrëveshjen formale të demilitarizimit dhe se pas përfundimit të kësaj, forcat e NATO-s “haptazi rreptë do të bëjnë demilitarizimin e UÇK-së, kjo është e qartë.”

109. Rëndësi të posaçme ka kryerja e demilitarizimit dhe transformimit të UÇK-së, nënshkruar më 20 qershor 1999, që rregullon armëpushimin e UÇK-së, shkëputjen e saj nga zonat me konflikt, demilitarizimin dhe reintegrimit pasues në shoqërinë civile. Është nxjerrë në pajtim me kushtet e Rezolutës 1244 duke pasur parasysh obligimet për të cilat është arritur marrëveshja në Rambuje dhe premtimet publike të bërë nga delegacioni shqiptar i Kosovës. Me anë të kësaj, UÇK-ja pranoi të heqë dorë nga përdorimi i forcës dhe të zgjidhë në mënyrë paqësore çdo pyetje apo çështje që ka të bëjë me zbatimin e kësaj. Një rregullore tjetër me interes është ajo e UNMIK-ut, Rregullorja nr. 2000/66 datuar 21 dhjetor 2000⁹⁹ që deklaroi se “për qëllime të rregullores aktuale, konsiderohet se konflikti i armatosur në Kosovë ka ndodhur në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershor 1999.”

110. Raporti nga ODNJ-ja ofron informata relevante mbi situatën në vend: “në pajtim me kushtet e marrëveshjes [MAT], KFOR hyri në provincë më 12 qershor dhe ushtria jugosllave dhe policia serbe (dhe paramilitarët) fluan tërheqjen nga Kosova në faza, kjo është pasuar me pezullimin e sulmeve të NATO-s. Më 20 qershor, të gjitha forcat e sigurisë serbe dhe jugosllave ishin tërhequr, duke lënë kështu Kosovën nën kontrollin e KFOR-it.”¹⁰⁰ Në rastin Vlastimir, Gjykata ka dhënë ca tregues lidhur me kornizën kohore të konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë. Gjykata tha “prej fundit të majit 1998, ekzistoi konflikt i armatosur në

Gjenevës (traktat që siç e shohim në paragrafin 88 dhe 114 poshtë, mund të konsiderohet si e zbatueshme për disa aspekte të konflikteve në ish Jugosllavi) poashtu tregon për një sferë të gjërë. [...]” (theksimi shtohet)

⁹⁶ Rezoluta e KSOKB 1244 (1999) datuar 10 qershor 1999, pika 3

⁹⁷ Ibid, pika 15

⁹⁸ brifingu mëngjesor i NATO-s nga Z. Jamie Shea, Zëdhënës i NATO-s, datuar 17 qershor 1999

⁹⁹ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/66 mbi përfundimet e luftës dhe familjarëve të atyre që vdiqën si rezultat i konfliktit të armatosur në Kosovë, datuar 21 dhjetor 2000

¹⁰⁰ Raporti nga ODNJ-ja, ‘nën urdhra, krime lufte në Kosovë’, Pjesa III, faqe 453

Kosovë në mes të forcave serbe, në veçanti në mes të forcave VJ dhe MUP dhe UÇK-së. Ky konflikt i armatosur vazhdoi të paktën deri në qershor 1999.”¹⁰¹

111. Të gjitha këto dokumente dhe raporte të nxjerra nga organizata joqeveritare dhe qeveritare e bëjnë të qartë se forcat serbe dhe grupet e UÇK-së akoma ishin të pranishme në territorin e Kosovës, se sulmet akoma vazhdonin dhe se demilitarizimi i UÇK-së akoma nuk kishte përfunduar më 10 qershor 1999. Trupi Gjykses gjen se që nga 15 qershori 1999, data e kryerjes së veprës penale, akoma nuk është arritur marrëveshja për paqe në mes të forcave serbe dhe jugosllave dhe anëtarëve të UÇK-së. Adoptimi i Rezolutës 1244 më 10 qershor 1999 nuk i dha fund konfliktit të armatosur në Kosovë. Ishte e kundërta, formulimi i rezolutës e bën të qartë se armiqësitë akoma po vazhdonin në territorin e Kosovës, siç u tha se dhuna dhe shtypja kryhej nga trupat jugosllave në Kosovë dhe sulmet e UÇK-së dhe grupeve të tjera të armatosura shqiptare në Kosovë ishin të qëndrueshme. Sipas mendimit të Trupit Gjykses, prania e trupave të NATO-s në Kosovë, edhe pse faktor krucial, nuk përjashton vazhdimësinë e sulmeve në mes të forcave serbe dhe grupeve të UÇK-së.

112. Prandaj, Trupi Gjykses gjen se gjendja e konfliktit të brendshëm të armatosur ka ekzistuar në territor të Kosovës në mes të UÇK-së dhe forcave të armatosura të sigurisë nga Republika Federative e Jugosllavisë, përfshirë forcat e ushtrisë jugosllave dhe Republikës së Serbisë deri të paktën më 15 qershor 1999.

Pjesëmarrja e të akuzuarit në konflikt të armatosur

113. I pandehuri kishte marrë pjesë në konflikt të armatosur në Kosovë. Fahredin Gashi vetë e pranoi gjatë seancës me polici më 23 korrik 2007 dhe në gjykatë. Ai deklaroi se i është bashkangjitur UÇK-së në mes të korrikut dhe se është stacionuar në fshatrat e Petreshtices dhe Krohimirit me batalionin 2 të Brigadës 121. Kishte pasur uniformën deri më 25 dhjetor 1998 dhe pas kësaj ai u sillte ushqim të burgosurve dhe kurrë nuk ka qenë i përfshirë në luftime. Ai në atë kohë kishte AK-47 dhe një revole dore. Fakti që ai ishte pjesë e UÇK-së është konfirmuar edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve. Ramiz Qeriqi dhe Naser Bytyqi deklaruan se Nazim Billaca dhe Fahredin Gashi ishin anëtarë të UÇK-së.

Ekzistimi i lidhjes në mes të konfliktit të armatosur dhe sjelljes kriminale

114. Sipas jurisprudencës, “ekzistimi i lidhjes përmban në vete një ndërlidhje të ngushtë veprë penale dhe armiqësive në vazhdim.” Krimi i pretenduar nuk do të thotë të ketë ndodhur në vend dhe kohë ku kishte luftime përderisa veprimet e kryerësit janë “të lidhura ngushtë” me armiqësitë që ndodhën në territoret nën kontrollin e palëve në konflikt. Ekzistimi i kësaj lidhje të ngushtë në mes të krimit dhe konfliktit të armatosur do të përcaktohet ku mund të tregohet se konflikti ka luajtur rol thelbësor në mundësinë që kryerësi të kryejë krimin, vendimin e tij apo të saj për ta kryer krimin, mënyrën në të cilën është kryer apo qëllimin për të cilin është kryer.¹⁰²

115. Mund të merren në konsideratë një numër faktorësh për të përcaktuar se a është mjaftueshmërisht akti në fjalë i ndërlidhur me konfliktin e armatosur: fakti se kryerësi është luftëtar; fakti se viktima nuk është luftëtar; fakti se viktima është anëtar i aplës së kundërt; fakti se akti mund të thuhet se i shërben qëllimit të madh të fushatës ushtarake; dhe fakti se

¹⁰¹ Lënda IT-05-87/1-T, Prokurori v. Vlastimir Dordevic, aktgjykimi i shkallës së parë, 23 shkurt 2011, para 1579

¹⁰² Lënda IT-04-84-T, Prokurori v. Ramush Haradinaj et al., aktgjykimi i shkallës së parë, 3 prill 2008, para 61

krimi është kryer si pjesë e apo në kontekst të detyrave zyrtare të kryerësit.¹⁰³ Si shembull, në rastin Latif Gashi et al., gjykata gjeti se “vetë natyra e të gjitha akteve që pretendohen në aktakuzë është e ndërlidhur me konfliktin e armatosur, pra një lidhje të ngushtë me konfliktin e armatosur. Në qendër të pretendimit ishte pohimi se personat e paraburgosur mbaheshin në paraburgim për shkak të bashkëpunimit të tyre të pretenduar me serbët apo për veprime të tjera të pretenduara kriminale, se trajtimi i tyre derisa ishin në paraburgim, përfshirë edhe kushtet në të cilat janë mbajtur si dhe vrasja eventuale e disa prej të paraburgosurve, të gjitha anë ndodhur në kontekst dhe si pjesë e përpjekjeve të UÇK-së në zonën e Llapit për të prapësuar dhe mundur forcat e armatosura të RFJ-së dhe atyre serbe.”¹⁰⁴

116. Është vërtetuar se në kohën në fjalë, Fahredin Gashi ishte anëtar i UÇK-së. Siç u vërtetua me deklaratat e të afërmeve të viktimës, Sali Gashi ishte bujk, pra civil. Është vërtetuar se ai është qëlluar për vdekje nga Fahredin Gashi për shkak të pohimit se ai ishte bashkëpunëtor i serbëve. Në fakt, në përgjigje ndaj pyetjes se pse Sali Gashi është vrarë, Nazim Bilaca tha “arsyeja ishte se ai ishte bashkëpunëtor i forcave serbe.” Fahredin Gashi i tha atij se Sali Gashi dinte diçka dhe se ai ishte bashkëpunëtor dhe se për shkak të kësaj, ata kishin mbrojtjen e instancave më të larta.

117. Duke pasur parasysh këtë që u tha më lart, nuk ka ndonjë dyshim që konflikti i armatosur ka psur rol të rëndësishëm në kryerjen e veprës penale dhe në përcaktimin që i pandehuri të veprës në mënyrë të tillë.

Statusi i viktimës prej civili

118. Një kusht tjetër për t’u plotësuar është që viktima e sjelljes kriminale të jetë anëtar i ‘popullatës civile’ siç parashihet me nenin 142, KP, RFSJ. Neni 3 i përbashkët me katër konventat e Gjenevës në para 1 i referohet “personat që nuk marrin pjesë aktive në armiqësi, përfshirë anëtarët e forcave të armatosura që kanë lënë armët si dhe ata që janë vënë jashtë luftimeve nga sëmundja, plagosja, paraburgimi apo ndonjë shkak tjetër.”¹⁰⁵

119. Në lëndën Ramush Haradinaj et al., gjykata gjeti se “kushti i fundit për zbatimin e nenit 3 është viktima të mos ketë pjesë aktive në armiqësi në kohën e kryerjes së veprës penale. Në mesin e të tjerëve, kjo përfshin edhe anëtarët e forcave të armatosura që kanë lënë armët si dhe ata që janë vënë jashtë luftimeve nga sëmundja, plagosja, paraburgimi apo ndonjë shkak tjetër. Kryerësi duhet të di apo është dashur të dinte statusin e viktimës si person që nuk ka pjesë aktive në armiqësi.” Në kontekst të konfliktit të brendshëm të armatosur, këta persona kanë të drejtë në mbrojtje sipas nenit të përbashkët 3, si dhe Protokollit Shtesë II.¹⁰⁶

120. Me kaq është vërtetuar se Sali Gashi ishte person i mbrojtur sipas nenit 3 i përbashkët me Konventat e Gjenevës dhe Protokollit Shtesë II, si person që nuk merrte pjesë aktive në armiqësi në kohën e veprës penale. Ai ishte bujk. Nuk ishte pjesë e trupave të UÇK-së apo të

¹⁰³ Lënda IT-96-23 and IT-96-23/1, Prokurori v. Dragoljub Kunarac et al., aktgjykimi i shkallës së dytë, 12 qershor 2002, para 59

¹⁰⁴ Lënda Gjykata e Qarkut Prishtinë, Prokurori v. Latif Gashi et al., P nr. 425/2001, aktgjykimi i shkallës së parë, 16 korrik 2003, faqe 14

¹⁰⁵ neni 4 para 1, Protokollit Shtesë II është i zbatueshëm “gjithë personat që nuk marrin pjesë direkte apo që marrin pjesë në armiqësi pavarësisht se a është kufizuar liria e tyre apo jo”.

¹⁰⁶ Lënda IT-04-84-T, Prokurori v. Ramush Haradinaj et al., aktgjykimi i shkallës së parë, 3 prill 2008, para 62

forcave serbe, dhe nuk kishte uniformë apo armë. Është e qartë se Fahredin Gashi e dinte se Sali Gashi nuk ishte palë e konfliktit të armatosur.

Pjesëmarrja e të akuzuarit në sjellje kriminale

121. Është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se Fahredin Gashi veprroi si kryerës kryesor. Ai ka kryer veprën penale me qëllim direkt ngase e ka ditur se veprimi i tij do të shkaktonte vdekjen e Sali Gashit.

Se sjellja kriminale shkelë ligjin vendor dhe rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohë të luftës (testi i dualitetit)

122. Konventat e Gjenevës, datuar 12 gusht 1949 janë miratuar nga Republika e Jugosllavisë më 21 prill 1950. Protokollet Shtesë I dhe II janë adoptuar më 8 qershor 1977 dhe kanë hyrë në fuqi më 26 dhjetor 1978 në Jugosllavi.¹⁰⁷ Neni 3 i përbashkët dhe Protokollit Shtesë II janë të zbatueshme gjatë konfliktit të armatosur me karakter jo-ndërkombëtar në territorin e një prej pesë palëve të larta kontraktuese. Miratimi i tyre mjafton për të obliguar palët në konflikt që t'u binden këtyre dispozitave. Këto instrumente ndërkombëtare kanë qenë të zbatueshme në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në territorin e Kosovës, territor i një pale kontraktuese. Vrasja e një anëtari i popullatës civile gjat konfliktit të brendshëm të armatosur ndalohet me këto dispozita.¹⁰⁸ Përpos kësaj, ky akt listohet si një ndër veprat penale në nenin 142, KP RSFJ.

IV.E. Përgjegjësia penale e të pandehurit Hysri Rama

123. Policia intervistoi të pandehurin Hysri Rama më 27 janar 2010. Në pyetjen se a ka shkruar ndonjëherë me Nazim Bllacën në fshatin Varigovc, ai u përgjigj se "ai [Nazim Bllaca] nuk më ka thënë pse ka dashur të bisedojë me atë familje dhe unë nuk kam mundur të dëgjoj bisedën sese isha 15 - 20 metra larg tyre. Nuk isha i interesuar për të pyetur se pse shkante të bisedonte me ata njerëz." Para Prokurorit më 29 tetor 2010, Hysri Rama e pranoi se ka shkruar dhe i ka dhënë një letër Haradin Gashit, babait të Fahredin Gashit. Ai sqaroi se në fillim Bllaca i tha atij se ai dhe Fahredin Gashi kanë vrarë Sali Gashin dhe "pas disa dite, Bllaca më tha se çfarë kisha shkruar në letër, pra që Fahredini nuk ka qenë përgjegjës dhe se ai vetëm donte të zhvaste të holla nga ai". Ai tha "krejt çka kam shkruar është ajo që kam dëgjuar nga Nazim Bllaca". Ai deklaroi se donte që familja e Fahredin Gashit të dinte se çfarë i kishte thënë Nazim Bllaca.

124. Duke bërë diçka të tillë, Hysri Rama qëllimisht strehon kryerësin e veprës penale. Kjo procedurë tregon se Dëshmitari Nazim Bllaca nuk ka bërë akuza të rreme ndaj Fahredin Gashi dhe se akuza pohohet. Qëllimi i tij është vërtetuar me deklaratat që ka dhënë policisë dhe prokurorisë dhe ka qëndruar pranë tyre në gjykatë.

¹⁰⁷ Shih RSFJ, Ligji për Miratimin e Protokolleve të Gjenevës, Medjunarodni Ugovori 1083, 26 dhjetor 1978

¹⁰⁸ Neni Article 3 i përbashkët me Konventat e Gjenevës: "Neni 3. Në rastin e konfliktit të armatosur me karakter jo-ndërkombëtar që ndodhë në territorin e një prje pesë palëve të larta kontraktuese, secila palë në konflikt ka obligim të zbatojë minimumin e dispozitave si në vijim: (1) [...] prandaj, janë dhe mbesin të ndaluara kudo dhe në cilëndo kohë sa u përket personave të lartpërmendur: a) dhunë ndaj jetës dhe personit, sidomos vrasja e çfarëdo lloji, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura; [...]"; neni 4, para 2 Protokollit Shtesë II: "2. Pa paragjykim parimit të përgjithshëm të asaj që u tha, veprimet vijuese kundër personave referuar në paragrafin 1 janë dhe mbesin të ndaluara në çdo kohë dhe në çdo vend: (a) dhuna ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies fizike dhe mendore të personave, në veçanti vrasje si dhe trajtimi mizor siç është tortura, gjymtimi apo çfardo forme e dënimit; [...]"

125. Nuk ka fare dyshim se vepra penale në fjalë, krim lufte kundër popullatës civile ndiqet *ex officio* dhe është e ndëshkeshme me burgim prej më shumë se pesë vjetë. Prandaj, Trupi Gjykses gjen se i pandehuri Hysri Rama ka kryer veprën penale dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprës penale në kundërshtim me nenin 305, para 2, KPK.

V. Dënimi

V.A. I pandehuri Fahredin Gashi

126. I pandehuri Fahredin Gashi shpallet fajtor për veprën penale krim lufte kundër popullatës civile në kundërshtim me nenet 22 dhe 142, KP RSFJ, penalizuar me nenet 23 dhe 120, KPK.

127. Për të llogaritur dënimin, Trupi Gjykses merr parasysh ligjin më të favorshëm për të akuzuarin. Trupi Gjykses gjen se nenet 38 dhe 142, KP RSFJ, që parashohin dënimin maksimal prej njëzet vjetëve burgim janë më të favorshëm për të akuzuarin se nenet 37 dhe 120 KPK.

128. Neni 142, KP RSFJ parasheh dënimin me burgim për jo më pak se pesë vjetë apo dënimin me vdekje për këtë veprë penale. Dënimi me vdekje është shfuqizuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24. Në pajtim me nenin 38, KP RSFJ, dënimi me burgim nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë apo më i gjatë 15 vjetë. Për më tepër, lejon gjykatën të sjellë dënimin me burgim prej 20 vjetëve për vepra penale të përshtatshme për dënimin me vdekje. Neni 120, para 1, KPK "kushdo që kryen shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949, dënohet me burgim prej të paktën pesë vjetë apo burgim afat-gjatë." Burgimi afat-gjatështa nga njëzet e një e deri në dyzet vjet, sipas nenit 37, KPK.

129. Gjatë sjelljes së dënimit, gjykata ka parasysh qëllimin e përgjithshëm të dënimit parandalimin e të pandehurit nga përsëritja e veprës penale. Për të përcaktuar kohëzgjatjen e dënimit, gjykata duhet të vlerësojë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në pajtim me nenin 41, para 1, KP RSFJ ekuivalent me nenin 64, KPP.

130. Për përcaktimin e dënimit, Trupi Gjykses mori parasysh faktorët rëndues si në vijim:

- Fahredin Gashi është kryerësi i drejtpërdrejt i veprës penale;
- Brutaliteti dhe mungesa e mëshirës dhe rrethanat (në prani të anëtarëve të familjes);
- Statusi civil i viktimës dhe
- Mospranimi i fajësisë nga Fahredin Gashi.

131. Si rrethanë lehtësuese e dënimit, Gjykata e Qarkut gjen se dënimi është kryer nën rrethana specifike, p.sh. gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë. Trupi Gjykses vë re kohën që kaloi nga kryerja e veprës penale dhe dhe sjelljes së mirë të të pandehurit gjatë procedurës penale.

132. Duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, Trupi Gjykses sjellë vendim për dënim me burgim prej tetëmbëdhjetë vjetëve për Fahredin Gashin për veprën penale krim lufte kundër popullatës civile, sipas nenit 22 dhe 142, KP RSFJ, penalizuar me nenet 23 dhe 120, KPK.

133. Koha e kaluar nga i pandehuri Fahredin Gashi në arrest shtëpiak nga 14 korrik 2010 deri 18 gusht 2010 dhe në paraburgim që nga 19 August gushti 2010, llogaritet në dënim në pajtim me nenin 50, para 1, KP RSFJ.

V.B. I pandehuri Hysri Rama

134. Gjykata gjen se Hysri Rama qëllimisht i ndihmon Fahredin Gashit për të evituar zbulimin e vrasjes. Duke qenë se vepra penale krim lufte kundër popullatës civile është e ndëshkueshme me më shumë se pesë vjetë burgim, vepra penale bie nën para 2 të nenit 305, KPK. Trupi Gjykues konsideron mospranimin e fajësisë së Hysri Ramës si rrethanë rënduese dhe karakterin më pak të rëndë të veprës së kryer penale dhe ndikimin e kufizuar në shoqëri si faktorë lehtësues.

135. Prandaj Hysri Rama dënohet me gjashtu muaj burgim për veprën penale dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprës penale, sipas nenit 305, para 1 dhe 2, KPK. Në pajtim me nenin 43, KPK, Gjykata e Qarkut sjellë dënim të suspenduar, dhe dënimi nuk zbatohet nëse Hysri Rama nuk kryen vepër penale për periudhën prej një viti.

136. Trupi Gjykues gjen se sjellja e një dënimi të tillë për të pandehurin mjafton për të përmbushur qëllimin e dënimit të paraparë me nenin 64, KPK.

VI. Shpenzimet e procedurës penale

137. Në pajtim me nenin 102, para 1 dhe 3, KPPK, të pandehurit Fahredin Gashi dhe Hysri Rama, të shpallur fajtor, do të mbulojnë shpenzimet e procedurës. Mungojnë të dhënat për të llogaritur shpenzimet e procedurës penale. Prandaj, Gjykata e Qarkut do të nxjerrë një vendim të veçant për shumën e shpenzimeve kur të pranohen të dhënat në fjalë në pajtim me nenin 100, para. 2, KPPK.

VII. Kërkesa për kompensim

138. Afrim Gashi, në cilësinë e tij si palë e dëmtuar ka ushtruar kërkesë për kompensim në Gjykatën e Qarkut më 30 shtator 2011. *Inter alia* ai kërkon kompensim për kohën e kaluar në gjykatë. Pasi që të dhënat në dosjen e lëndës nuk ofrojnë dokumentacion të mjaftueshëm për të llogaritur saktë kompensimin, Gjykata e Qarkut udhëzon palën e dëmtuar në ndjekë kërkesën e tij me lëndë civile, në pajtim me nenin 112, para. 2, KPPK.

Kryetar i Trupit Gjykues

Gjykatës Dr. Horst Proetel

Anëtar i Trupit Gjykues

Gjykatës Tore Thomassen

Anëtar i Trupit Gjykues

Gjykatës Rafet Haxhaj

Proces-mbajtës

Robert Abercombie

Mjet ligjor

Në pajtim me nenin 400, KPPK, palët duhet të lajmërojnë ankesë menjëherë pas shpalljes së aktgjykimit apo pas udhëzimit mbi të drejtën për ankesë, por jo më vonë se tetë (8) ditë pas shpalljes së aktgjykimit. Palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë ndaj aktgjykimit në Gjykatën Supreme të Kosovës nëpërmjet Gjykatës së Qarkut në Prishtinë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dhënies së një kopje të aktgjykimit, në pajtim me nenin 398, para 1, KPPK.